Kumbona e së Diellës

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.9/10, Shtator - Tetor 2016

KISHA
NDËRSHQIPTARE

Emrat e 38 martirëve, viktima të komunizmit në Shqipëri (1945-1971).

Kush janë 38 martirët e Kishës Ndërshqiptare, që do të Lumturohen më 5 nëntor 2016:

Imzot Vinçenc Prennushi;
Imzot Frano Gjini;
Imzot Jul Bonati;
Dom Alfons Tracki;
Dom Anton Muzaj;
Dom Anton Zogaj;
Dom Dedë Maçaj;
Dom Dedë Malaj;
Dom Dedë Plani;
Dom Ejëll Deda;
Dom Jak Bushati;
Papa Josif Mihali;
Dom Zef Maksen;
Dom Lazër Shantoja;
Dom Lekë Sirdani;
Dom Luigj Prendushi;
Dom Marin Shkurti;
Dom Mark Gjani;
Dom Mikel Beltoja;
Dom Ndoc Suma;
Dom Ndre Zadeja;
Dom Pjetër Çuni;
Dom Shtjefën Kurti;
Atë Bernardin Palaj;
Atë Çiprian Nika;
Atë Gaspër Suma;
Atë Gjon Shllaku;
Atë Gjovani Fausti;
Atë Daniel Dajani;
Seminaristin Mark Çuni;
Atë Karl Serreqi;
Atë Mati Prendushi;
Atë Serafin Koda;
Vëlla Gjon Pantalia;
Fran Miraka;
Qerim Sadiku;
Gjelosh Lulashi;
Rishtarja stigmatine
Maria Tuci.

Papa Fraçesko
MËSHIRË E INTEGRIM 4

Imzot Angelo Massafra
DETYRA E KRISHTERË 7

Redaksia
KISHA ËSHTË E VETËDIJSHME 9

Don Lush Gjergji
ALBERT SCHWITZER 10

Don Nosh Gjolaj
GRUPIMET NË GJIRIN FAMILJAR 13

Eugjen Merlika
SHENJTËRESHA NËNË TEREZË 17

Dom Nikë Ukgjini
NDIMESA PËR KOMISINË LETRARE 21

Dr. Tonin Çobani
FISHTOLOGJIA 23

Redaksia
KONFERENCË PËR GJON VLADIMIRIN 27

VITRINA E LIBRIT 28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXX, nr. 9/10 (487-488) Shtator - Tetor 2016

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
***Imzot* Angelo MASSAFRA**

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PAPA FRANÇESKU: MËSHIRË E INTEGRIM PËR TË GJITHA FAMILJET

Nga Enciklika: "Amoris Laetitia"

Mëshirë dhe integrim: ky është thelbi i Nxitjes Apostolike pas sinodale "Amoris Laetitia – Gëzimi i dashurisë", nënshkruar nga Papa Françesku më 19 mars dhe paraqitur sot në Romë. Në 200 faqet e shkruara thjeshtë, në mënyrë që të gjithë të mund ta lexojnë pa probleme, Ati i Shenjtë flet për "dashurinë në familje" konkretisht, me fjalë që ngrohin zemrën e që të bëjnë t'i shfletosh me dëshirë e shpejt faqet, pavarësisht nga gjatësia e tekstit. I ndarë në nëntë kapituj, dokumenti është rezultat i dy Sinodeve mbi familjen, të cilët u mbajtën në vitin 2014 dhe në vitin 2015.

Nxitja Apostolike e shmang vendosjen e martesës e të familjes në dy binarë: nga njëra anë, familjet e rregullta, ku gjithçka shkon mirë e, nga ana tjetër, gjendjet "e parregullta", që përbëjnë problem. Papa Françesku i konsideron këto dy realitete gjithnjë në ecje. Edhe familja e ashtuquajtur "e rregullt" dhe një martesë ku gjithçka "shkon mirë" duhet të mësojë gjëra të reja, të kapërcejë etapa të caktuara, mund të haset me mëkatin e dështimin, të ketë nevojë të pajtohet e t'ia fillojë edhe një herë nga e para.

Kap. I. Fjala e Zotit në familje dhe drama e refugjatëve

Mëshirë dhe integrim, pra: "Amoris Laetitia" është shkruar mbi këto dy boshte, që përbëjnë arkitraun mbi të cilin mbështetet mendimi i Papës. Kapitulli i parë i dokumentit, kushtuar Fjalës së Zotit, vë në dukje bukurinë e çiftit të formuar nga burri e gruaja, pa harruar dramën e papunësisë dhe "të shumë familjeve të refugjatëve, të refuzuara e të pambrojtura".

Kap. II. Realiteti dhe sfidat e familjes. Sprova e madhe e persekutimit

Më pas, duke cituar Sinodet, Papa kujton sfidat e shumta të familjeve, në ditët e sotme: mendësinë kundër lindjes së fëmijëve; emergjencën e strehimit; abuzimet me të miturit, "edhe më shkandulluese" kur ndodhin në familje, në shkolla e në institucione të krishtera; "sprovën e madhe" të persekutimit të të krishterëve"; "shpërbërjen juridike të familjes", që synon "barazimin e thjeshtëzuar me martesën" të bashkimeve të faktit, ose të bashkimeve ndërmjet njerëzve me të njëjtin seks; nënat me qira; disa ideologji si ajo gjinore apo "gender", që përpiqen të imponojnë "një mendim të vetëm". Para kësaj gjendjeje, kërkon Papa, të krishterët duhet ta vendosin Sakramentin e martesës në kuadrin e një baritorie "pozitive dhe mikpritëse", pranë njerëzve të ligshtë, baritori e aftë të tregojë rrugët për arritjen e lumturisë.

Kap. III. Thirrja e familjes dhe e drejta e patjetërsueshme për jetën

Në këtë këndvështrim, pazgjidhshmëria e martesës nuk duhet kuptuar si ndonjë "zgjedhë" e sakramenti nuk është "rit i zbrazët, konvencion shoqëror", por "dhuratë për shenjtërimin e shëlbimin e bashkëshortëve". Papa Françesku rithekson me forcë "vlerën e madhe të jetës njerëzore" dhe "të drejtën e patjetërsueshme për jetën e fëmijëve të palindur akoma", duke nënvizuar detyrimin moral të veprimtarëve të krishterë të shëndetësisë për të mos kontribuar në aborte. Gjithashtu, Ati i Shenjtë vë në dukje se të gjithë kanë të drejtë të jetojnë deri në vdekjen e natyrshme, si edhe shprehet me vendosmëri kundër dënimit me vdekje.

Kap. IV. Dashuria në martesë është dashuri miqësie

Por cila është atëherë, dashuria që jetojmë në martesë? Papa Françesku e quan "dashuri miqësie", sepse bashkon pazgjidhshmërinë e Sakramentit me dëshirën për të kërkuar gjithmonë të mirën e tjetrit, karakteristikë e miqësisë së sinqertë. Dashuria e miqësisë, për Papën, ka të bëjë me konceptin e

dashurisë së krishterë, "caritas", sepse "të hap sytë dhe të lejon të shohësh sa vlen njeriu". Në këtë këndvështrim, Ati i Shenjtë nënvizon edhe rëndësinë e jetës seksuale të bashkëshortëve, që e përshkruan me fjalët "dhuratë e mrekullueshme", "gjuhë ndërnjerëzore", e cila na bën të kuptojmë "vlerën e shenjtë dhe të padhunueshme të tjetrit".

Kap. V. Dashuria bëhet e frytshme. Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë nënë e babë

Pastaj, duke u ndalur në lindjen dhe mikpritjen e jetës brenda familjes, Papa nënvizon vlerën e embrionit "që nga çasti i zënies", sepse "çdo fëmijë është gjithnjë në zemrën e Zotit". Që këndej, këshilla e ftesa për të mos e parë fëmijën si "plotësues apo zgjidhje për aspiratat personale", por si "një qenie njerëzore me vlerë të pamasë", të cilit i duhet respektuar dinjiteti, "nevoja dhe e drejta e natyrshme për të pasur një nënë e një babë". Njëkohësisht, Ati i Shenjtë u shpreh afërsinë çifteve, që s'mund të kenë fëmijë, dhe u kujton se mund të jenë prindër në mënyra të ndryshme, për shembull, përmes birësimit. Papa bën thirrje të përmirësohen ligjet e procedurave adoptive dhe të kujdestarisë për fëmijët, gjithnjë në interes të të miturve, duke luftuar trafikun e paligjshëm.

Kap. VI. Disa perspektiva baritore. T'i shoqërojmë bashkëshortët nga afër

Në gjysmën e dokumentit për dashurinë familjare, Papa rithekson temat sinodale dhe vë në pah nevojën për t'i shoqëruar të fejuarit në udhën e përgatitjes për martesë. Gjithashtu, nënvizon se bashkëshortët duhen ndjekur, sidomos në vitet e para të martesës. Kisha duhet të formojë njerëz të aftë për një baritori familjare misionare, që kujdeset për çiftet e nuk është thjesht një "fabrikë kursesh" për elita të vogla. Natyrisht, në kohën tonë është rritur shumë numri i divorceve, gjë që Papa e konsideron shqetësuese, prandaj bën thirrje të parandalohen fenomene të tilla, sidomos për të mbrojtur fëmijët, të cilët nuk duhet të bëhen "pengje" të njërit apo të bashkëshortit tjetër. Pa harruar se, para dhunës, shfrytëzimit dhe prepotencës, ndarja është e pashmangshme dhe "moralisht e nevojshme".

Respekt për homoseksualët, por asnjë analogji ndërmjet martesës dhe bashkimit gay

Përsa u përket njerëzve me prirje homoseksuale, theksohet nevoja për respektimin e dinjitetit të tyre, pa i diskriminuar padrejtësisht. Por, nënvizohet në Nxitjen Apostolike, "nuk ekziston asnjë bazë" për të vendosur analogji "as të largëta" ndërmjet bashkimit homoseksual dhe martesës sipas planit të Zotit. E në këtë pikë, është "e papranueshme" që Kisha të vuajë nga "presione" të çdo lloji.

Kap. VII. Të forcohet edukimi i fëmijëve, e drejtë-detyrë e prindërve

Mjaft i gjerë, kapitulli i shtatë, që i kushtohet edukimit të fëmijëve, "detyrë e rëndësishme" dhe "e drejtë parësore" e prindërve. Larg së qeni kontroll i ekzagjeruar, edukimi duhet të jetë "promovim i lirisë së përgjegjshme", mësim i "aftësisë për të pritur", takim i prindërve me fëmijët. Papa shprehet në favor të edukimit seksual, por nënvizon se ai duhet kuptuar si "edukim për dashurinë", që duhet të jepet "në çastin e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme", duke i mësuar fëmijët edhe të kenë "turp të arsyeshëm", pra të jenë të ekuilibruar. Së fundi, transmetimi i fesë, sepse familja duhet t'i mësojë e t'i pranojë arsyet dhe bukurinë e saj.

Kapitulli VIII: Të shoqërohen, të dallohen e të integrohen familjet në vështirësi

Lidhur me familjet, që jetojnë çaste të vështira, Papa pohon se nga Nxitja Apostolike nuk duhet pritur ndonjë normativë e përgjithshme e tipit kanonik, e zbatueshme për të gjitha rastet. Prandaj barinjtë duhet ta promovojnë martesën e krishterë sakramentore, bashkim përfundimtar, i lirë e besnik i burrit me gruan; por duhet edhe t'i pranojnë, t'i shoqërojnë e t'i ndjekim me mëshirë situatat e vështira. "Mos të na ndodhë që të gabojmë rrugë – shkruan Françesku – rruga e Kishës është gjithjë ajo e Jezusit: mëshirë e integrim", rrugë që nuk e dënon askënd në amshim, por ua dikon mëshirën e Zotit të gjithë njerëzve, që e kërkojnë me zemër të sinqertë, sepse në logjikën e Ungjillit "askush nuk mund të dënohet përgjithmonë".

Jo, normës kanonike të përgjithshme; gjykim plot përgjegjësi rast për rast

Të integrohen të gjithë - porosit Nxitja – edhe të divorcuarit e rimartuar, që mund të marrin pjesë në jetën e bashkësisë përmes angazhimeve shoqërore ose takimeve të lutjes. E edhe të reflektohet se cilat përjashtime aktuale liturgjike e baritore mund të kapërcehen me një gjykim të përshtatshëm, në mënyrë që të divorcuarit e rimartuar të mos ndjehen "të shkishëruar". "Nuk ekzistojnë receta të

thjeshta"- pohon Papa - mundemi vetëm të inkurajojmë një gjykim të drejtë të rasteve të veçanta, sepse "grada e përgjegjësisë nuk është e njëllojtë për të gjithë".

Eukaristia nuk është çmim për të përkryerit, por ushqim për të ligshtit

Në dy nota në fund të faqes, Papa ndalet tek disiplina sakramentore për të divorcuarit e rimartuar: në notën e parë pohon se gjykimi baritor mund të pranojë se në një situatë të veçantë "nuk ka faj të rëndë" e, prej këndej, "edhe efektet e normës nuk duhet të jenë doemos të njëjta" në të gjitha rastet. Në notën e dytë, Françesku nënvizon se "në disa raste", posaçërisht në rastet e vështira, ndihma e Kishës "mund të jetë edhe ndihma e Sakramenteve", sepse "rrëfyestorja nuk duhet të jetë sallë torture" e "Eukaristia nuk është çmim për njerëzit e përkryer, por ushqim për të ligshtit".

Ligjet morale nuk janë gurë

Por është themelore - nënvizon Papa - garancia e kushteve të "përvujtërisë, maturisë, dashurisë për Kishën", për të shmangur "mesazhet e gabuara" që mund të krijojnë përshtypjen se Kisha ndjek një "moral të dyfishtë", ose se sakramentet janë privilegj vetëm për disa e për t'u shkëmbyer me favore. Sepse është vërtet gjë e ultë ta vlerësosh veprimin e njeriut vetëm mbi bazën e një norme.

E, po aq e vërtetë, edhe se ligjet morale nuk mund të jenë "gurë për të gjuajtur me ta besimtarët"; prandaj Kisha nuk duhet të heqë dorë në asnjë mënyrë nga propozimi i idealit të plotë të martesës.

Pa e prekur idealin ungjillor, duhet ndjekur logjika e dhembshurisë ndaj njerëzve të brishtë, sipas parisë së dashurisë së krishterë, që nuk i vë kushte mëshirës së Zotit, por përpiqet të kuptojë, të falë, të shoqërojë, të integrojë!

Kapitulli IX: Përshpirtëria bashkëshortore dhe familjare. Krishti i ndriçon ditët e hidhura

Në kapitullin e fundit, Amoris Laetitia fton për ta jetuar lutjen në Familje, sepse Krishti e bashkon dhe e ndriçon jetën familjare edhe në "ditët e hidhura", prej këndej, Papa nxit që familja të mos shikohet "si realitet i përkryer e i realizuar një herë e përgjithmonë", por si zhvillim gradual i aftësisë që ka secili për të dashur. "Të ecim, familje, të vijojmë të ecim!"- është ftesa përfundimtare e Françeskut, që i inkurajon familjet e botës të mos e humbasin shpresën!

DETYRA E KRISHTERË PËR TË DHËNË SHPRESË

Takim mbi Veprat e Mëshirës sot në Evropë
Sarajevë, Bosnje Hercegovinë, 15-18 shtator 2016.

Mëshirë do të thotë të mos largohesh nga dhimbja, nga padrejtësia dhe nga vuajtjet e shumta të kohës sonë por ti bëjmë rast shprese dhe shpëtimi nëpërmjet dashurisë së krishterë. Në cilëndo vepër mëshire, është njeriu, me dinjitetin dhe plotësinë e tij, pikënisja dhe pikëmbërritja e veprimtarisë së Kishës. Por edhe në ushtrimin e mëshirës, nuk mjafton puna e rastësishme që shpesh është fryt i emocionit të ndryshueshëm dhe shpie në lënien e detyrës dikujt tjetër duke hequr përgjegjësinë. Në veprat e bamirësisë është i thirrur çdo i krishterë dhe e gjithë bashkësia e krishterë, të bashkëndash dhe të dëshmosh: është sa pjesëmarrësit në takimin **CCEE** të Sarajevës kanë shprehur në katër ditët e tyre të punës (15-18 shtator).

Duke quar më përpara një ecje të nisur së bashku me organizma të ndryshëm katolik evropian (CAritas Evropa, Conece, Komisioni Drejtësi dhe Paqe Evropa, FEAMC, ICMX, ICCPPC, FEBA, UNIAPAC), Komisioni CCEE *Caritas in Veritate*, në bashkëpunim me Konferencën ipeshkvore të Bosnjë-Hercegovinës ka promovuar një takim mes atyre që në Evropë janë protagonist të Veprave të Mëshirës. Ka qenë edhe rasti për një reflektim mbi urgjencën, aktualitetin e Mëshirës sot në Evropë dhe mbi format e ndryshme të angazhimit të Kishës.

Punimet kanë parë çaste të ndryshme reflektimi dhe dëshmie që kanë treguar se si në qendër të veprimtarisë së Kishës është personi njerëzorë. Nuk është një individ anonim, por është ndaj personit, në kufizimet e të qenit të tij krijesë gjithnjë në nevojë për marrëdhënie jo vetëm njerëzore por edhe të përvojës së dashurisë së Hyjit, ndaj të cilit përkulet Kisha kur ushqen nëpërmjet Bankës ushqimore, kur viziton burgjet, kur pret migrantin apo refugjatin, kur kuron dhe viziton të sëmurin, kur varros të vdekurin, kur mbron punën e nevojtarit apo qon në botën e politikës thesarin e doktrinës sociale të Kishës. Nga veprimtaritë e shumta të ngritura nga këta organizma kishtare del në pah një ndjenjë falënderimi e shprese të gjallë për guximin krijues dhe aftësinë që sjellë risi me anë të të cilave përballen format e ndryshme të varfërisë. Nëpërmjet Veprave të Bamirësisë, Kisha katolike në Evropë e di që po edukon mbi ndjenjën e vuajtjes njerëzore, që njeh dhe vlerëson vlerën e çdo jete njerëzore dhe shmang përjashtimin e personave. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit vënë në dukje disa fenomene që i bëjnë thirrje ndërhyrjen e Kishës dhe të krejt shoqërisë në Evropë.

Në një kohë sfidash të mëdha, duket më shumë

se kurrë urgjente ti japësh shpresën Evropës. Kjo është e mundur nëpërmjet një pranie që jeton një dashuri të krishterë të ungjillëzuar që nuk zvogëlohet në sentimentalizëm të thjeshtë. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit kanë vënë në dukje shumë herë se si privatizimi i besimit në Vendet e shekullarizuara ka sjellë shpesh një ndarje mes veprave të bamirësisë shpirtërore dhe atyre materiale, sepse veprat "materiale", të kuptuara si shprehje publike të besimit, nuk priten gjithmonë mirë nga institucionet shekullare. Pikërisht, jo rrallë herë, aparati juridik dhe administrativ i ndërtuar nga Qeveritë në Evropë, megjithëse vlerëson shërbimin tejet të madh që organizatat e ndryshme kishtare i japin gjithë shoqërisë, duket se kërkon të zvogëlojë angazhimin e krishterë si filantropi e thjeshtë duke e zhveshur nga lidhja fetare. Shumëfishimi, ndryshimi dhe pesha e aparatit juridik dhe administrativ e bëjnë sot të vështirë të mbarështohet shoqëria. Me kalimin e kohës, të gjithë këta përbërës kanë sjellë një ndarje mes "veprës", që lind nga besimi dhe shpalljes së krishterë: nganjëherë duket se mund të bësh mirë vetëm nëse paguan çmimin e heqjes dorë nga shpallja e Krishtit. Nëse Kisha, dënon qartësisht një veprimtari mëshire që ka për qëllim proselitizmin, nga ana tjetër na kujton se, për të krishterin, nuk është e mundur të ndash veprat nga besimi, sepse është pikërisht personi i Krishtit që është burimi dhe mbështetja.

Në mesazhin e tij pjesëmarrësve, Papa Françesku ka kujtuar nevojën e "ndihmesës për rilindjen e Evropës" dhe të ëndërrojmë "një humanizëm të ri evropian" duke nxitur "përfaqësuesit e selive ipeshkvnore evropiane, që të përfshin gjithnjë e më tepër bashkësinë dhe realitetet e ndryshme të mëshirës dhe përkujdesit në angazhimin e shpalljes së Ungjillit atyre që kanë humbur për arsye të ndryshme orientimin e jetës së tyre". Vetëm në këtë mënyrë Kisha mund "të jetë një nënë krijuese të proceseve, pra pjellore, sepse respekton jetën dhe fal shpresa jete."

Në Sarajevë, përgjegjësit e organizmave kishtarë kanë vënë në dukje edhe se si, përballë formave të ndryshme të "varfërisë", materiale dhe shpirtërore, është e nevojshme jo vetëm ti përgjigjemi urgjencës që lidhet me vuajtjen, duke dhënë një shërbim apo një prani që mund të zbusë dhimbjen e çastit, por përkundrazi të punojmë së bashku me personin në vështirësi, duke angazhuar të gjithë bashkësinë dhe duke komunikuar rreth kësaj varfërie. Dëshmitë e shumta të sjella këto ditë kanë vënë në dukje se si veprat e bamirësisë janë të lidhura bashkë. Prandaj urojmë që organizmat e ndryshëm kishtarë të mund të vazhdojnë të mbështesin njëri-tjetrin dhe të zhvillojnë forma të reja bashkëpunimi. Pikërisht është krejtësisht e nevojshme që, aty ku ndërhyn një organizëm kishtar, të ndihet e thirrur e gjithë bashkësia e krishterë. Një komunikim i drejtë duhet pastaj të nxis një ndërgjegjësim që prek të gjithë njerëzimin. Pikërisht, përpallë vuajtjes së njerëzimit nuk ka asnjë pengesë fetare apo politike "të gjithë duhet të ndihemi bashkëpërgjegjës të mirëqenies së tjetrit", kanë thënë pjesëmarrësit.

Së fundmi, në Sarajevë, qytet emblematik i kohës sonë për vuajtjet e shumta të përjetuara dhe për plagët ende të hapura nga një konflikt që ka zgjatur vite dhe nga marrëveshje – si ato të Dejtonit – të cilat po favorizojnë një politikë të mosndryshimit dhe diskriminimit mbi baza etnike, mëshira e Kishës shfaqet nga vepra të shumta, si ajo e Shkollave për Evropën – njëra nga gjashtë veprat e bamirësisë të vizituara nga pjesëmarrësit – të hapura gjatë konfliktit, për të dëshmuar që lufta nuk ishte një nevojë, as ndarje etnike një fatalitet, por që bashkëjetesa paqësore ishte dhe është gjithnjë e mundshme.

Duke u bashkuar me Atin e Shenjt që do të udhëheq takimin e Paqes, me datë 20 shtator në Asizi, pati lutje për Paqen, shenjë e qartë e mëshirës hyjnore, veçanërisht në Ukrainë dhe në Vendet e Lindjes së Mesme.

KISHA ËSHTË E VETËDIJSHME PËR DETYRIMIN E SAJ

Deklaratë për shtyp e Përfaqësuesve të Konferencës Ipeshkvore të Evropës Qendrore e Lindore Bratislav, Slovaki, me 8-9 shtator 2016.

Njëzeteshtatë vjet pas rënies së regjimit komunist në Evropën qendroro-lindore, Evropa përballet me sfida të reja. Më të mëdhatë mes tyre janë kriza e familjes, e lidhur me krizën demografike dhe kriza e besimit të identitetit kulturor. Së fundmi, shumë vende përballen me migracionet e shumta me prejardhje nga Lindja e Mesme dhe Afrika. Në datat 8 dhe 9 shtator, përfaqësuesit e Konferencave Ipeshkvore të Evropës Qendrore e lindore janë takuar në Sllovaki, vend që kryeson Këshillin e Bashkimit Evropian, për të reflektuar mbi këta tema.

Sipas pjesëmarrësve është themelore që mes shteteve evropiane të ketë një partneritet i vërtetë i bazuar mbi dinjitetin e njëjtë të të gjithë popujve dhe mbi respektin e ndërsjellët. Në të njëjtën mënyrë, është e rëndësishme që strukturat publike, kombëtare dhe evropiane të zhvillojnë një dialog të vërtetë me përfaqësuesit e Kishave të krishtera apo me përfaqësuesit e besimeve të tjera.

Ipeshkvijtë mendojnë se është e nevojshme të nxisin reflektimin mbi identitetin Evropian, i cili ka qenë gjithnjë i lidhur me familjen e bazuar në martesën mes një burri dhe një gruaje. Vetëm një shoqëri me fëmijë është një shoqëri me shpresë. Kisha është e vetëdijshme për detyrimin e saj të dëshmisë së lajmit të mirë të Krishtit në botë. Dhe për këtë arsye e vlerëson dhe e ndihmon familjen, shoqërinë njerëzore të themeluar sipas planit të Krijuesit. Fatkeqësisht, disa vendime të strukturave evropiane e vënë familjen dhe mbrojtjen e jetës në rrezik. Sot, Evropa, para së gjithash ka nevojë për familje që qëndrueshme dhe për një politikë demografike të kujdesshme. Emigrimi nuk është një zgjidhje e krizës demografike.

Pjesëmarrësit në takim janë prekur thellë nga vuajtja e personave që janë duke ikur nga mosmarrëveshjet ushtarake, sidomos ato që po shkatërrojnë Sirinë. Në të njëjtën kohë, ndjejnë dhimbje për sulmet terroriste të bëra në Evropë, me shumë viktima. Për pasojë, mendojnë të drejtë të zhvillojnë më shumë komunikimin me botën islamike dhe ti kushtojnë më shumë përpjekje ndihmës ndaj personave më në nevojë në bazë të urdhrit hyjnor të dashurisë. Ipeshkvijtë ndjejnë detyrën e veçantë të ndihmës për të krishterët e persekutuar, por nuk përjashtojnë nga zemra e tyre asnjë person tjetër njerëzor që ka nevojë për ndihmë, si në rajonet në krizë në botë, ashtu edhe në vendet tona.

Duke pasur si synim këta qëllime njerëzore dhe të krishtera, duhet të ecim përpara me bujari dhe mençuri, duke vlerësuar rrethanat kulturore, fetare dhe ekonomike të popujve evropian dhe të atyre që vijnë. Ipeshkvijtë e vënë re ndryshimin themelor mes gjendjes në vendet evropiane, që janë pikëmbërritje të flukseve migratore dhe të atyre të Evropës qendrore e lindore, që janë vende transiti – me një tenor jete që arrin vetëm 20% të atij perëndimor. Në këta vende, migrantët në përgjithësi nuk dëshirojnë të qëndrojnë. Ndihma që duket ti jepet atyre kërkon veprime të veçanta, dhe nganjëherë të ndryshme nga ato që janë përdorur nga vende të tjera. Në gjithë këtë kontekst, është e drejtë dhe e nevojshme të mendojnë se si të planifikohet e ardhmja e kontinentit evropian, mbi cilat vlera të ndërtojmë shoqërinë dhe cilin vend të ruajmë për besimet.

Ipeshkvijtë luten për të gjitha viktimat e dhunës, luftës dhe terrorizmit. Në të njëjtën kohë, i drejtojnë një thirrje të fortë përgjegjësve të gjitha vendeve evropiane që të zhvillojnë një reflektim të thellë e të përbashkët mbi të ardhmen. Urojnë që Evropa të bëhet një kontinent që vë në vend të parë respektin ndaj jetës njerëzore – nga ngjizja deri në vdekje – dhe që mbështetja ndaj familjes dhe martesës të zërë vendon e parë në vetëdijen e përfaqësuesve publik.

Don Lush GJERGJI
Prishtinë

ALBERT SCHWEITZER
(1875 – 1965)
(Pjesa e parë)

"Lypset që të shpëtohet personi njerëzor për ndërtimin sa më të më mirë të shoqërisë. Njeriu, pra, si një tërësi, në bashkim të trupit dhe të shpirtit, të zemrës dhe të ndërgjegjes, të mendjes dhe të vullnetit, do të jetë qendër e tërë shqyrtimit tonë". (GS 3)

"Askush nuk mund të kuptojë që dëshira për t'i shërbye të afërmit, siç predikoi Jezusi, do të mund ta shtynte dikë që të ndryshojë jetën e vet. Edhe pse të gjithë e lexojnë Ungjillin, të gjithë besojnë në Jezu Krishtin…".

Albert Schweitzer



Albert Schweitzer ishte bir i një pastroi protestant i lindur në Kaiserberg në Alsasci, atëherë nën sundimin e Gjermanisë. Qysh si i vogël u tregua se kishte një inteligjencë të hershme dhe të jashtëzakonshme, i shëndoshë dhe i bukur, gëzim i vërtetë i familjes së tij. Nga moshatarët e tij dallohej edhe për nga standardi jetësor. Familja e tij ishte shumë më e pasur se sa familjet tjera. Ky fakt i ka krijuar shumë vështirësi në komunikimi me bashkëmoshatarë.

Albert Schweitzer rrëfen këtë hollësi nga fëmijëria e tij: *"Bie bora e parë. Ne fëmijët ishim të lumtur që mund të loznim dhe argëtoheshim në borë. Kisha dy luftim me shokun nga klasa ime. E mposhta dhe me këtë u tregova se jam më i fortë se ai. Ia afrova dorën dhe e ftova të ngritët. Ai refuzoi dorën time dhe me zemërim më tha: 'Po të kisha unë për ushqim atë që ngrënë ti, me siguri do të kisha mundur në borë'. Në mbrëmje isha në shtëpi, dhe kur duhej të ngrënia darkë, u ula pranë tavolinës, mirëpo nuk desha të haja asgjë. Mendoja gjithnjë në bashkëmoshatarët e mi të shkollës, të cilën rrinë ulur pranë tavolinave të zbrazëta dhe pa asgjë. Atë ditë zbulova se sa vështirë është të jesh i mjerë,i varfër. Në veten time, ndjeva një frymëzim: "Ti duhesh të ndërmarrësh diçka për këta të varfër!".*

Albert Schweitzer kishte edhe një ndodhi në jetë e cila e kishte prekë thellë në zemër. Shëtiste me të atin e vet dhe heton një përmendore kushtuar një zezaku, kështu që e pyet atin*: "Pse kjo trupore e cila paraqet zezakun i cili është jashtëzakonisht i fortë, ka sytë aq të tmerruar?".* I ati ia shpjegoi: *„Im bir, ky zezak është nga Gaboni, vendi më i varfër në botë. Ata që lindin atje vuajnë nga varfëria e skajshme…".*

Edhe ky shpjegim i atit e shtyri të mendonte shumë mbi varfërinë.

Familja e tij jetonte në Günsbach, ku i ati kryente detyrën e pastroi. Kur ishte në moshën 14 vjeçare, pas përfundimit brilant të shkollës fillore, Alberti vazhdoi shkollën e lartë në Mülhausen. Ishte jashtëzakonisht i talentuar, në veçanti për muzikë. Qysh në moshën pesë vjeçar i binte organos në kishë, dhe kështu kishte përfituar simpatinë e të gjithë besimtarëve.

Muzika e Bachut

Përveç muzikës, ai donte edhe përshpirtërinë, meditimin dhe uratën. Shpeshherë dhe me kënaqësi lutej në vetmi. Pikërisht në kishën famullitare në Mülhausen dhe në bibliotekën e atjeshme zbuloi

partiturat e Bachut. Së pari ato i gëzoi dhe shijoi personalisht, kurse më vonë muzikën e Bachut iu bëri të arritshme edhe të tjerëve duke mbajtur koncerte të jashtëzakonshme nëpër tërë Europën.

Kur ishte 18 vjeçar u regjistrua në univerzitetin e Strasbourgut, mirëpo muzika ishte pasioni i tij i madh, ndoshta edhe më saktë të themi, ishte jeta e tij. Si 22 vjeçar doktoroi në teologji, pak më vonë edhe në filozofi. Ishte bërë edhe një ndër organistët më të njohur në Europë. Dhuntia për muzikë dhe studime me të madhe ia hapën dyert e karrierës universitare. Me vetëm 24 vjet arriti të bëhet profesor universitar në Strasbourg.

Ja dëshmia e tij nga kjo periudhë jetësore: *„Ishte mëngjesi i Rrëshajave. Ende isha në shtrat ku dëgjoja zërin e kambanave dhe zërin e brendshëm timin. Ëndrra ime më e mirë jetësore tashmë ishte realizuar. Para meje ishte një jetë madhështore. Mirëpo, mendimi im ishte drejtuar kah ajo mori e cila nuk ka asgjë... Mu kujtonin fjalët e shokut tim të klasës: ' Po të kisha unë për ushqim atë që ngrënë ti...' si dhe fjalët e atit tim para përmendores kushtuar zezakut: ,Ata cilët lindin atje janë më të varfëritë në botë...' Kujtoja fjalët e Ungjillit: , Atyre të cilëve iu është dhënë shumë, nga ata edhe do kërkohet shumë...Falas morët, falas jepni...Predikojeni Ungjillin...Shëroni të sëmurët...“*.

Pas lutjeve dhe meditimeve të shkurtra, vendosi që edhe për gjashtë vite radhazi t'i kushtohej muzikës, filozofisë dhe teologjisë. Në ndërkohë vendosi të studionte edhe mjekësinë. E pastaj? Atëherë në tërësi do t'i kushtohej shërbimit të të varfërve, dhe atë pikërisht në Gabon. Me mendje dhe zemër tashmë ishte atje. Me sy të hapur ëndërronte atë vend dhe popull i cili e shqetësonte, e thërriste dhe priste. Shpeshherë i dukej se ishte ndalur koha. Mirëpo, prapë duhet pasur durim me vetveten, me kohën, me obligimet e veta profesionale, kështu që në vetvete thoshte: më pritni, unë së shpejti do të vij!.

Po, koha në Gabon ishte „kasap“ i cili pret dhe vret, rrënon e shkatërron atë botë të mjerë.

Misioni në Gabon

Në prill të vitit 1913 Albert Schweitzer arriti në Lambareneu, në Gabon, së bashku me gruan e vet Helenën. E pritën dy misionarë, atë Christol dhe atë Ellenbergu, me dy klasë nxënësish të shkollës së misionit.

Në fytyrat e fëmijëve mund të shihej gëzimi për ardhjen e mjekut. Kishte shumë lule, por mbi të gjitha aq duar, aq sy, aq gojë, aq fytyra të cilat dukeshin sikur hije dhe rrezatonin vetëm me shpresë e cila lindëte në ta…

Familja Schweitzer jetoi në një shtëpizë, si shumë familje tjera. Në mëngjesin e parë më të arritur panë edhe pamjet e para të mjerimit, vuajtjes: shumë nga ta ishin të varfër, të veshur dobët, të uritur, të sëmurë dhe të rraskapitur. Shtëpiza tashmë ishte e rrethuar me të sëmurë të shumtë. Shumë prej tyre qanin dhe kërkonin ndihmë, sepse këtu nuk ka asgjë përpos mjerimit dhe vuajtjes. Albert Schweitzer dëshironte të bënte pak rregull, mirëpo ishte e kotë. Nevoja, varfëria, mjerimi, ishin më të fortë se ata, më e rrëmbyeshme se çdo arsye tjetër.

Në veçanti e preku numri i madh i njerëzve me gërbulur, por edhe i shumtë të tjerë me lëngata të panjohura. Të gjithë ishin tubuar para shtëpizës, bërtitnin, qanin, thirrnin, dëshironin ta shprehnin në çfarëdo mënyre vuajtjet e tyre. Kështu prapë edhe një herë e kujtoi përmendoren dhe shikimin trishtues të zezakut, por edhe shpjegimin e të atit… Realiteti është i ashpër dhe shumë i rëndë, njerëzit të shtrembëruar, mundësitë e vogla, thuajse kurrfarë.

Me gruan e vet Helenen, punonte pa ndërpre, pastronte, shëronte, ushqente, mirëpo harku i të sëmurëve ishte i pafund. Gjithësesi i dukej se nga ora në orë bëhet edhe më i madh, më i gjatë. Ditët e para të qëndrimit dhe punës ishin të tmerrshme. Së shpejti u harxhuan edhe barërat. Përpos gjitha këtyre mundimeve paraqiten edhe magjistarët, të cilët e kërcënuan nëse nuk tërhiqet së shpejti nga territoret e tyre.

Ja dëshmia e tij: *„Rreth 26 apo 27 prillit, dëgjova fishkëllimën e trenit. Për mua ishte kjo fishkëllima e ringjalljes. Arritën 70 paketime me barëra të ndryshme. Menjëherë harrova tmerrin, frikën, shqetësimin, të gjitha. Atë ditë bëra operacionin e parë. Erdhi tek unë një zezak, krejt i varfër, duke qarë. Ia vura dorën time në ballë dhe i thash: ,Mos u frikëso, tani do të flesh dhe kur të zgjohesh, nuk të kesh më kurrfarë dhimbje në stomak'. Kur u zgjua nga anestezioni, gjithnjë bërtiste: „Unë nuk kam më dhimbje, nuk kam më dhimbje!' Përpos sëmundjeve të ndryshme dhe varfërisë së madhe kishte edhe të këqija të shumta tjera ndaj të cilave është dashur të luftohej, e sipas mundësisë edhe të ngadhënjehej: gjendja familjare, kulturore, në përgjithësi ajo shoqërore ishte jashtëzakonisht e rëndë. Disa fise të qeta dhe paqësore, ishin gjithmonë të sulmuara nga fiset*

tjera, gati se fise kanibalë, të cilat bile edhe ushqeheshin me mishin e njeriu (fiset Pahouins dhe Galaosins). Misioni protestën ishte pikërisht në mesin e këtyre fiseve. Pa masë kësaj kishte edhe shumë besëtytni, ku magjistarët, të cilët kishin rolin vendimtar, terrorizonin njerëzit. Vërtet ata vendosnin për gjithçka, në duar të veta kishin fatin e jetës dhe vdekjes, të mirës dhe të keqes, të dashurisë dhe të urrejtjes… Kush iu kundërshtonte ishte i dënuar për vdekje. Shumë kanibal, shpeshherë kanë sulmuar edhe spitalin, në veçanti repartin e kirurgjisë".

Pas këtyre dhe sprovave tjera të ngjashme, iu kujtuan Albert Schweitzerit fjalët e një kreu të një fisi i cili i tha: „*Vendi ynë ngrënë bijtë e vet.*" Këto rrethana dhe vështirësi e sollën atë te dyshimi, gati edhe deri te dëshpërimi. Pyetej: *„Vërtet, po kush jam unë që të kam mundësi të luftoj kundër të gjitha këtyre të këqijave dhe gjithë këtij mjerimi? Ndoshta isha tepër mendjemadh, naiv, sipërfaqësor, krenar e kështu arrita në këtë gjendje?*"

Mirëpo, Zoti nuk e le kurrë askënd tërësisht të vetmuar. Gjithmonë dërgon ndokënd, së paku një shenjë të vogël të pranisë së tij. Për Albert Schweitzerin në momentet e vuajtjeve të mëdha, tensioneve, frikës, dyshimit, dhembjes, gati se edhe keqardhjes, bashkëshortja Helena ishte engjëlli i ngushëllimit, përkrahjes, frymëzimit. Ajo i thoshte: *„I dashuri Albert, këtu jeta është e rëndë. Vallë nuk erdhëm këtu pikërisht për këtë? Vendasit janë dembelë, gënjeshtarë, hajna, nganjëherë edhe vrastarë. Kush i detyron të jenë të tillë? Mali, magjistarët, shumë tregtarë të cilët blejnë dhe shesin robër…Nëse i lëmë edhe ne, Jozefi dhe shumë bashkëpunëtorë tanë, të cilët janë të mirë, edhe këta prapë do bëhen hajna dhe vrastarë, sepse vetëm ashtu do të mund të mbijetojnë në xhunglën e Gabonit. Kush e dhuron jetën e vet për të tjerët, ai do të shpëtojë, do të gjejë jetë. A të kujtohet kush i tha këto fjalë, Albert i dashur?*"

Pas "terapisë, shpresës dhe inkurajimit" të këtillë, Alberti ndihej më i qetë, më i sigurt se kurrë më parë. Zoti i foli përmes gruas së tij Halenes. Iu kishte kthye vetëbesimi, falënderimi, entuziazmi.

Mirëpo, njeriu sapo e gjen paqen, gjithnjë gjendet edhe ndonjë "dreqëz" i cili e mundon me kërcënime dhe sfida të reja. Në vitin 1914, i shkruajnë miqtë nga pjesë të ndryshme të Europës, se Europa është çmendur, përgatitet për luftë, prodhon armatim, krijon njësi të reja ushtarake.

Në ditarin e vet Albert Schweitzer shkruan: *"Nëse bëhet luftë, atëherë kjo në Gabon do jetë parajsë në krahasim me Europën. Këtu vrasjet janë lufta mes njeriut me njeriun. Në luftën evropiane masakrimi do jenë modern, automatik. Do të shkatërrohen hapësira të tëra dhe shumë njerëz, kështu që luftërat e mëparshme do të jenë të tejkaluara, lojë fëmijësh në krahasim me këtë që po përgatitet.*"

Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

ME ÇDO KUSHT TË MPOSHTEN PARTITË APO GRUPIMET BRENDA GJIRIT FAMILJAR

(Pjesa e parë)

1. Si ndikojnë anëtarët e familjes së gjerë në jetën e çiftit të ri?

Në planetin tonë ashtu të quajtur "Blu", thuajse nuk ka bashkësi ideale edhe më pak bashkësi martesore që do të ishte ideale. Sepse vet njeriu si i tillë nuk është i përsosur por e bartë me vete mungesat, dobësitë qofshin të vetëdijshme qofshin ato të pavetëdijshme. Rastet e shumta të dashuruari e imagjinojnë martesën si një farë ishullit të izoluar në të cilën do t'i realizojnë ëndrrat e jetës. Zakonisht pas martese apo fill pas muajit të mjaltit ata e përjetojnë realitetin e hidhët. Së parit ata nuk banojnë në ndonjë "ishull" të izoluar nga mjedisi, por në rastet e shumta jetojnë nën një kulm për pos çiftit martesor, aty zakonisht është nëna e djalit apo e nuse, baba vëllezërit, motrat; po qe se banojnë në qytet vinë edhe kushërire apo farefisi, po ashtu aty kthehen miqtë, shokët e punës bëjnë konak etj. Menjë fjalë çifti si i tillë nuk është i izoluar, por gjithherë gjendet dikush tjetër, qoftë në vizitë qoftë në banim, për të cilët duhet edhe një kujdes i veçantë, përndryshe të dalin fjalët, ashtu fitohet edhe epiteti i dobët.

Parimisht mund të themi: sa më i madh është numri i anëtareve i familjes nën njëjtin kulm, aq më shumë kokëçarje dhe probleme dalin në sipërfaqe, për harmonin e përhershme aty fare nuk mund të flitet. Në rëndin e parë është ajo vjehrra, e cila është engjëlli i rojës i bashkëshortëve të ri, pastaj mos të flasim për rivalitetin në mes rejave po qe se ka më shumë në atë familje apo kunatave, çka të themi rivaliteti mes vëllezërve, pleqve etj, etj. Për ta krijuar një farë harmonie në rrethanat e tillë posaçërisht me mendësinë e sotme është e pamundur, sepse kërkon nga ana e çiftit jo vetëm durim, mençuri por edhe shkathtësi diplomatike, taktike e mos të themi nervat e kalit, për ndryshe shumë shpejt do të përfundojnë në ndonjë zyre psikiatrike, sepse atyre do t'u mungojnë ato fuqitë e brendshme për ta bartë barrën e jetës së përditshme. Jo vetëm se çifti i bartë problemin, hallet, ankesat, vështirësitë e brendshme por tani i lajmërohen jo vetëm edhe hallet e bashkëshortit apo bashkëshortes por edhe anëtarëve të gjirit familjar duke filluar nga vjehrra, e cila jo vetëm se u pengon por edhe i ngarkon çiftin e ri me marrëzira e veta apo me thashetheme, atëherë çka të themi për çdo anëtar tjetër i familjes, menjë fjalë bashkëjetese na gjirin familjar me anëtarët e shumët thuajse harmonia e jeta e fatlumen është e pamundur por asaj i kërcënohet shkatërrimi jo vetëm i jashtëm së bashkësisë martesore por edhe ai i brendshmi, duke e humbur unin, vetveten, identitetin e mos të flasim për mosrealizimin e ëndrrës së jetës - mosrealizimi i dashurisë. Shumë rrallë mund të gjinden anëtarët e shumët të një familjes, të cilët e posedojnë një kulturë të ngritur apo civilizim, një dinjitet njerëzor e një pjekuri të plotë, thuajse një pohim i tillë sot për sot është jo real apo imagjinatë. Si bie fjala, jo vetëm dikur por edhe sot e kësaj ditët kemi mjaft anekdota në llogari të vjehrrës apo të vjehrrit, qofshin në raportin ndaj nuses së re qofshin në raportin ndaj djalit. Ky lloj "kujdesi" jo vetëm se e dëmton personalisht nusen e re por ia rrëmben entuziazmin e brendshmen, ia kufizon lirinë, të drejtën e mendimit dhe të vetëvendosjes, e mos të themi se dashuria i imponohet apo i dhunohet. Në rastet e shumta shprehet nga anëtarët e familjes kujdesi i tepruar posaçërisht e vjehrrës e cila

dëshiron në çdo mënyrë ta mposhtin unin, apo egon e nuses duke u bërë tutele, e cila jo vetëm se e fyen personalitetin e çiftit të ri, por edhe u dikton mënyrën se si ata duhen të jetojnë. Zakonisht vjehrra ndërhyrë në rëndin e parë në punët e brendshme të çiftit të ri, siç bie fjala ajo është, e cila do të kujdesohet për çështjen ekonomike, edukative menjë fjalë këshilltare numër një. Çmimi është teje i lartë për bashkëshortit e ri të cilët kanë vendosur për të jetuar në gjirin e familjes me më shumë anëtarë nën një kulm. Por sot u këshillohet çifti të ri, pa marrë parasysh thashethemet e mjedisit, të largohen sipas mundësive nga gjiri familjar dhe të strehohen më mirë në një dhomë të dobët diku të izoluar, jashtë diapazonit të ndikimit të familjes së gjerës se sa në pallate e mëdha luksoze. Para se të vendoset martesa është e domosdoshme e zgjedhja e banesës, po qe se dëshirojnë për ta realizuar dashurinë, fatlumturin dhe të ketë jetën e gjatë.

a). Vjehërr e re

Përpara se përshkruajmë psikologjinë e vjehrrës me renë, ia një përshkrim i Fishtës:

"Paska kenë motit nji plakë,
Qi s'kisht' pasë tjetër nafakë,
Veç nji djalë edhe nji re
E'i dhamb n'gojë - dh'ate n'de-de.
Sa pat djalin, medje, plaka,
Nuk u ankue fort kah nafaka;
Perse i biri bukë u bite,
Me hjek keq bash fort s'i lite;
Veç se shka kisht' ra n'bela
Me re t'vet sa ma nuk ka;
Me hanë pisk ishin kenë pa.
Paj, si Kshndellash si per Pashkë,
Bukë e gjak veç hajshin bashkë,
Njekaq gverra kishte hi,
M'kambë shoshoqen m'e perpi
Kjate plaka rrkajë lot:
-Nafak-premja vetë, o Zot,
Se shka prita në pleqni
Se shka prita me qitë n'shpi...
Ketë gjarpnushë, ketë farë arpijet,
Qi m'dua djalit edhe shpijet...
Paska kenë ngallicë e vjeter:
Me i pre kryet,po, i del nji tjeter!...
Mos me pvet, jo tjeter gja,
Veç se mjaft kush e ka ba...
Oh! po a ama... e kam njoftë vetë.
Besa fort.. he-he! me m'pvetë,
Un qes bolla... edhe shum...
Por s';po flas hallakatrum,
Veç po u thom se kto janë shkrum.
Tri herë n'vjet, po, sado pak,
S'rrijn pa i nxjerë teshat n'sokak,
Pse qira-s'kanë kurr me la...
E kjo shtrembe, hi si duqe,
Mos me i ba dy pare t'kuqe,
Qi veç ktu me bukë asht ngi,
Shkon tue m'shitë nji kal kreni...
Ani kush... e bija e hores,
Le e rritë n'xhubletë t'malcores.-
-Besa t'njoh, mori ti nanë-
Niste e reja atë-herë me i thanë,
Qi e kisht' pasë gjuhen rrufe,
-Besa t'njoh, mirë fort kush je!-
-Shka nje ti, mori gjarpnushë-
Xete plaka me u perpushë,
-Shka njoh ti, qi m'a dha malin,
Nanes s'vet tu' i da, heu! djalin
Ah! dij vetë shka t'lypet ty...
Por s'ke burrë,jo,me t'ulë krye...
Tatalosh: mili, mili;
Pitigona:vili,vili;
Nana digjet si fitili!
Edhe tash po don me m'thanë:
Besa t'njoh, mori ti nanë!-
-Besa t'njoh, morti lum nana;
Veç mos m'ban me i vjellun t'ana..
Oh! po t'njoh...edhe t'njoh mirë...
Por kurse, bare, t'and bir;
Pse s'po t'thom,jo,per kojshi,
Qi s'po len me u rritun fmi.-
-Ah!bre hider, "shtrigë" po m'thue
Kriste plaka tu'u turfllue,
Edhe u njitshin flok per flok,
Tu' i shkue votres rrok-e m'rrok.-
Pse do'dijtë ktu nji fjalë tjeter,
Qi per shtrigë atë rrole t'vjeter,
Thonë se e mbate edhe shum kush
Prandejk plaka bahej prush,
Edhe ndezej porsi rrfeja,
Sa herë "shtrigë" i thonte e reja.
Kshtu tu' u gri shoqe me shoqe,
Shkuen do mot ato marroqe.
Kur qe i biri i plakës u lig,
Edhe i ngrati u ba per vig,
Due me thanun, diq e shkoj
E borxhlive grues i pshtoi."

(At Gjergj Fishta, "Anzat e Paranasit", Prishtinë më 1990, fq. 124-126).

Raporti në mes nuses apo të resë dhe të vjehrrës thuajse është mbi kohor, i përjetshëm, e gjithherë dhe në çdo vend e kulturë apo civilizim, posaçërisht shkakton mos kënaqësinë në gjirin martesor. Në të vërtetë është në fjalë raporti në mes moshës së vjetër dhe asaj të resë. Në këtë rast vlen ende ajo deviza e vjetër, se të rinjtë e të vjetrit nuk shkojnë së bashku. Kjo vlen edhe më tepër po qe se është banesa ose shtëpia e vogël. Përderisa në fshatra është dukshëm më lehtë sepse shtëpia është shumë më e madhe e mendësia e rrethit ndikon më tepër në jetën e familjes.

Fatkeqësisht ngarkesa biologjike është e thadruar thellësisht në endësin e njeriut që e ngarkon mendësinë rinore e atë të moshuarve, e cila nuk mposhtet aq lehtë.

Preferohet po qe se është e mundshme, mos të jetojnë së bashku të moshuarit me të rinjtë, sepse dallimi është i madh, përderisa në dallime nxitet edhe tendosja dhe prej tendosjet fillon konflikti që tejkalon në urrejtje e mos të themi në kanibalizëm e në grindjet e përhershme.

Kuptohet çdo çift i ri, dëshiron ta rregullojë e ta stolisin banesën e përbashkët. Thuajse është dëshira e parë e çdo çiftit martesor për të cilën edhe ëndërron, se si do të jetojnë "ndryshe". Shijet janë të llojllojshme, përderisa nevojat janë diçka tjetër, e në tjetrën anë edhe kushtet e jetës dita-ditës ndërrohen, menjë fjalë njerëzit e ri jetojnë krejtësisht ndryshe se si kanë jetuar prindit e tyre.

Në të kundërtën pleqtë apo të moshuarit nuk e lëshojnë rolin e prindit por ata duhet t'i këshillojnë fëmijët e tyre. Në syrin e pleqve gjithherë janë fëmijë, siç thotë një anekdotë: Nëna 105 vjeçe e këshillon bijën 75 vjeçe: "bijo kij kujdes e mos të mashtrojë ndonjë djalë!" Po ashtu prindërit jo vetëm se frikohen për fëmijën e vet por edhe i japin këshillat preventive, se si duhet të kursehet, si duhet të edukohet, si duhet të sjellën në botën e përditshme. Menjë fjalë prindit janë plotë e përplot me përvojat e jetës që tani me kujdes u ndajnë në veçanti çiftit të ri. Atëherë nuk është për t'u habitur se çfarëdo novitetit, prindit e ndjekin me vërejte e mosbesim. Si bie fjala: "dikur kemi mundur edhe pa të, pse edhe ju dy nuk mundi? Sepse është e panevojshme". Ose "o Zot ka shkon bota e sotme, ne dikur nuk i kemi pasur të gjitha këto gjëra edhe kemi jetuar bile më mirë." etj.

Më e keqja është po se vërejtjet janë urdhëruese: "Po qe se fjala e jonë nuk vlen, atëherë çka kërkoni prej neve!" "Këtë ne nuk e kemi sjellë në shtëpi, atëherë as nuk do ta prekim me dorë!" ose "Nusja është e mençëm e ta bëjë ajo se di më mirë se ne!" Akuzimet e fajësimet vazhdojnë aq gjatë saqë jeta bëhet e padurueshme mos të themi e tmerrshme!

Më e keqja është, po qe se dallimi është shumë i

madh në mes çiftit të ri e prindërve. Si bie fjala nëna arrin nga fshati, për ta vizituar djalin që jeton në qytet, i cili është inxhinier, e ka paganen mujore të mirë, banesën luksoze, veturën. Po ashtu ja jep pagën edhe shërbëtoren për t'ia pastruar e kujdesuar shtëpinë. Nëna fillon ta sulmojnë nusen (të ren) e cila ishte mjeke: "Ty nuk të ka falë Zoti për asgjë, je vetëm poshtra e botës, që e shfrytëzon djalin tim, sepse të ishe ti grua e mirë, do t'i kryesh të gjitha punët e shtëpisë, e atëherë nuk është e nevojshëm për ta paguar shërbëtoren!"

Nusja e djali e dëgjojnë nënën, shërbëtoren e përjashtojnë apo e largojnë nga puna. Vjehrra e merr kuzhinë po ashtu edhe kujdesin e shtëpisë, por ajo vazhdon fajësimin për ta sulmuar nusen: "Çka mendon ti, unë të behëm shërbëtorja e jote, zonja kaq e rëndë të lozin me mua, kjo nuk do të ndodhë askurrë!Konflikti e mos kënaqësia nuk ka fund dhe ata vendosin, që nënë e djalit (vjehrra) e tyre të kthehet në fshatë, apo të shkojnë te e bija, ose çifti është i gatshëm për t'ia paguar një banesë veçmas për të, vetëm për vete të kenë qetësinë e duhur.Pas pakë kohëve bashkëshorti i lodhur nga puna fillon ta faksojnë bashkëshorten: "Ti e përjashtove nënën time nga shtëpia!"

Menjë fjalë tjetër si prindit e tyre ashtu edhe fëmija gjinden në rrethin magjik, që nuk ka rrugëdalje. Për këtë është e rëndësishme fill pas martesës, çifti i ri të jetojë të ndamë nga prindit.

Sepse jeta e çiftit të ri në bashkësinë e prindit jo vetëm se nuk e përjetojnë dashurinë, bashkësinë por ia sjellë si vetes ashtu edhe tjerëve ferrin e vërtetë. Akuzimet e fajësimet kurrë nuk kanë të ndalur. Sa do është e mirë nëna, e urtë, e mençur, po qe se nuk e ka mposhtur kompleksin e Ediptit, dhe si e tillë është gusht e lidhur me fëmijën e vet, në veçanti me djalin, në të cilin është e dashuruar, kuptohet në këtë rast në mënyrë të tepruar. Një dashuri e tillë jo vetëm se është e dështuar por e shkakton vdekjen e bashkësisë martesore te çifti i ri. Sepse nga thellësia e saj lajmërohet impulsi i posedimit qoftë i vetëdijshëm apo pavetëdijshëm, sepse atë dashurinë që e ka ndaj djalit tani ia ka rrëmbyer njeriu i huaj në këtë rast nusja, dhe ajo mbetet e zbrazët, e vetmuar, e hutuar e në mënyrë spontane fillon impulsi të realizohet me sjelljet e pahijshme, të paturpshme, panik ose histerike, në rastet e shumta, ajo fillon ta marrin në duart e veta pushtetin, duke uzurpuar të drejtat e çiftit të ri, e në anën tjetër ç'u imponon qëllimin e vet, kuptohet në fillim në mënyrë të fshehë e perfide pastaj çeltas dhe me një arrogancë të pashoqë! Në këtë rast sa do është nusja e mirë, fisnike, e urtë, ajo do ta gjejnë siç thotë proverbi popullor: "e kërkon qimen në ve!"

Po ashtu edhe po qe se është nëna me baraspeshën e normales, e pjekur, që është ideale jo vetëm ndaj fëmijës dhe bashkëshortit por edhe ndaj nuses, bashkëjetesa mund të jete e ngarkuar. Gjithashtu edhe ndaj vjehrrës, e cila është e ngarkuar, me mizat apo teket e veta, di nganjëherë nusja e re ta krijojnë baraspeshën e jetës, sepse bashkëshorti nuk është i verbët për mençuri për ta frenuar karakterin ose temperamentin e gruas ndaj vjehrrës, e ai respekton gjendjen në tërësi. Burrat janë zakonisht të tillë, që dëshirojnë që të gjitha gratë të janë në mes vetes në raportet e mira, mos të mbretërojnë fjalët e panevojshme, që shatojnë shamatë e grindje që e bëjnë jetën e përbashkët të pamundur. Po qe se gruaja këtë pamundësi e realizon, atëherë ai edhe më tepër e do atë. Gruan po ashtu mund ta largosh apo ta tjetërsosh nëpër mes vjehrrës apo ta fitosh. Është mjaft e varur prej tij. Detyra shprehet përpara çiftit të ri që e kanë jetën përpara vetes e jo për para prindërve të cilët e kanë realizuar apo jo realizuar jetën e tyre. Si djali ashtu edhe nusja duhet të posedojnë jo vetëm trimëri apo guxim por edhe freski e humor që do ta pranojnë vjehrrën, duke ia shprehur mirëkuptimin e duke kuptuar dëshirat e saja, duke ia kthyer vëmendjen ndaj saj, që ajo e ndjen veten të sigurt, e ashtu është edhe e kënaqur. Me tjera fjalë nusja nuk bënë të jetë e ndjeshme apo e prekshme por çdo gjë e pranon me kënaqësi e mirësi, e nuk e lejon vetes për të hyrë në rrethin magjik në të cilën nuk ka dalje.

Ashtu kemi arritur deri te shkretëtira e gjelbër, ashtu edhe ajo vjehrra e pamundur mund të bëhet e nevojshme dhe e pazëvendësueshme në jetën e përditshme. Jo vetëm se do t'i kryejnë punët e shumta, që i duhet nuses për t'i kryer, do ta zëvendësoi edhe shërbëtoren, por bëhet dora e djathtë posaçërisht në edukimin e fëmijëve. Përpos kësaj vjehrra ka edhe përvojat e paçmueshme të jetës, që u mungojnë njerëzve të rijnë. Ashtu çdo gjë e vjetër nuk është për ta hedhë. Zakonisht vajza e dinë mirë dhe në mënyrë instinktive di të përshtatet vjehrrës. Si vajzë që është dashuruar në dashnorin, e për t'ia arrit qëllimin ajo i afrohet nëpër mes vjehrrës. Sepse ajo, jo vetëm se i shërben dhe ia bënë qejfin por edhe i harmonizon mosmarrëveshjet mes djalit dhe nënës, që djalit këtë gjest e miraton edhe më tepër, e dashuron të fejuarën apo dashnoren në fund nusen. Ajo (nusja) gjithherë e thërret vjehrrën jo me emër por thjeshtë "nënë"!

Eugjen MERLIKA

SHËNJTËRESHA NËNË TEREZË DHE SHQIPTARËT NËNË TEREZA E KALKUTËS

"Un nuk jam veçse një laps i vogël në duart' e Zotit. Është Ai që shkruan, është Ai që mendon, është Ai që vendos

Romë 4 shtator 2016

Me 4 shtatori 2016 do të jetë një datë e skalitur me shkronja të ndritëshme në histori. Shënjtërimi i Nënë Terezës, në shekull Anjeze Gonxhe Bojaxhiu, një bijë e popullit tonë, e lartësuar me hirin e Jezu Krishtit në botën e së vërtetës hyjnore, krahas gëzimit, entuziazmit, kënaqësisë deri në krenari për gjakun e saj shqiptar, mendoj se është edhe një shtysë përsiatjeje të thellë mbi të shkuarën tonë, veçanërisht në lidhje me Të.

Historia e Shenjtëve të Krishterimit është shumatorja e historive të njerëzve, burra e gra, të cilët Perëndia i përzgjodhi mes krijesave njerëzore, i pajisi me frymën e saj dhe i ngarkoi secilit misionin që të vinte në jetë mësimet e saj. Ato apo ata patën jetë të gjata apo të shkurtëra, në mundime, vuajtje e dhimbje, në shembëllim të Birit të Zotit, kaluan Kalvarin e tyre, duke vërtetuar çdo ditë se njeriu nuk është një qënie e përsosur, se në të bashkëjetojnë e mira dhe e keqja, se megjithë vështirësitë e mëdha të luftës brënda vetes, me frymën e Qielllit dhe vullnetin e tokës njerëzit mund të gjejnë rrugën e Zotit. Shënjtët janë modelet, shëmbujt, udhërrëfyesit, ata që lindin një në qindra milionë, përçues të dritës Hyjnore mes mëkatarëve e vdekëtarëve të thjeshtë.

Një e tillë ishte edhe Nënë Tereza e lumturia e jonë, si shqiptarë, qëndron në faktin se edhe në mes të popullit tonë, jo shumë i dalluar në historinë e tij për fuqinë dhe qëndrueshmërinë granitike të besimit fetar, Jezu Krishti dhe Virgjëresha Marie zgjodhën një vajzë të thjeshtë si "*drita e tyre ndërmjet të varfërvet*", duke e bërë këtë vajzë zëdhënësen e Tyre më besnike e më të ndritur në botën e shekullit më mizor të historisë së njerëzimit.

Anjeze Gonxhe Bojaxhiu ishte brumë i magjes shqiptare, i gatuar me miellin zero të grurit të fushave të Kosovës, e mbruajtur me respektin e fjalës së dhënë e me plotësimin, deri në vetmohim, të misionit të marrë përsipër. Ajo ishte pjellë e Shqipërisë së traditës, që njihej në dyshen e bashkangjitur "Fè e Atme", të kënduar nga poeti kombëtar At Gjergj Fishta. Por këtu mbaron roli i Shqipërisë në veprimtarinë e bijës së saj, edhe se ajo mbeti në zemrën e saj të përvëluar nga malli, aq sa të pohojë botërisht në ceremoninë më të rëndësishme të jetës së saj botërore, kur i u dha Çmimi Nobel : "*Nga gjaku dhe origjina jam shqiptare....*"

Shqipëria, e dalë nga gati gjysmë mijëvjeçari pushtimi osman, së cilës, për të krijuar një ndërgjegje kombëtare, të domosdoshme për jetën e saj të pavarur, i duhej të ushqehej me mite heronjsh të vërtetë e të sajuar, me legjenda lashtësie e qëndrese mbijetese, e përcolli me një farë heshtjeje rrugën e murgeshës së re, që kishte zgjedhur Urdhërin e Loretos, në Hindinë e largët, për të vënë në jetë mësimet e Jezusit mbi mëshirën e krishterë. E shkëputur nga familja e atdheu, e kushtuar tërësisht për rreth pesëmbëdhjetë vjet arsimimit, jo vetëm të vajzave të familjeve të pasura të Kalkutës, por edhe fëmijëve të varfër të saj, murgesha Terezë

kalonte jetën e saj misionare, në qetësinë e rreptësinë e Kuvendit dhe në intimitetin e lutjeve. Deri më 1948 Motra Terezë ishte një nga shërbyeset e heshtura të Jezusit, ndërmjet mijërave të tilla në të katër anët e botës. Jeta e saj e njohur shoqërore filloi me daljen nga Urdhëri e shtytur nga një vizion hyjnor i një bisede me Krishtin dhe Virgjëreshën, e me themelimin e shoqatave të saj të bamirësisë e të "Misionareve të Mëshirës".

Kjo jetë mbeti krejtësisht e panjohur për shqiptarët e republikës popullore, jo vetëm për zotimin kundër fetar skajor të regjimit, por edhe për mungesën e theksuar të njohurive dhe lajmeve e, ndoshta, edhe për një mospërputhje mendësie mes fakteve të kujdesit të murgeshës shqiptare për më të varfërit e të varfërvet të Hindisë, duke u pastruar me dorë krimbat nga mishi i "arixhinjve" dhe koncepteve të "burrërisë" e "trimërisë" shqiptare. Shqipëria zyrtare qe e ftohtë dhe mospërfillëse kundrejt veprës së saj madhore me përmasa planetare, deri sa Akademia Suedeze e Shkencavet, më 1979, do t'i jepte asaj Çmimin Nobel për "Mbrojtjen e Paqes". Mërgata shqiptare jashtë mbante lidhjet me murgeshën e madhe, por hendeku mes saj dhe regjimit të Vendit të saj të lindjes që, në gjysëm shekulli, qe shprehja më e përkryer e gjithshkaje t'errët e mizore, që ishte në gjëndje të prodhonte kombi shqiptar, u thellua e u zgjerua në përmasa katastrofale. Regjimi i Enver Hoxhës, me cinizmin karakteristik të huajtur nga OZNA serbe apo GPU-ja sovjetike, modelet e policive politike të admiruara e të përvehtësuara deri në përnjisim nga Sigurimi i Shtetit shqiptar e quajti murgeshën Terezë të Kalkutës si njeri që "*përdorej gjërësisht nga Vatikani dhe Gjon Pali i II për aktivitete propagandistike kundër vendt tonë", "një agjente e rrezikëshme", "një armike"* që duhej mbajtur në mbikqyrje edhe në Hindinë e largët, mbasi "rrezikonte" lirinë e Shqipërisë.

Si pasojë e kësaj mendësie u arrit në kulme të cinizmit kriminal, të shfaqur nga zyrtarë të lartë të rangjeve të ndryshme, që nga ambasadorët shqiptarë në Vende të huaja, deri tek znj. Vito Kapo në Meksikë, e cila lutjeve të nobelistes shqiptare, të veshur me sarin hindian, për të biseduar me të i u përgjigj me mospërfilljen dhe vrazhdësinë e spikatur të kastës së saj se"*nuk kemi çfarë të bisedojmë bashkë"*. Ky qe çasti kulmor i i keqtrajtimit të hapur të Shënjtëreshës shqiptare, qe një thikë e ngulur në shpirtin e saj të madh, qe plaga më e thellë që mori "krenaria" për gjakun shqiptar që i rrihte në deje. Por dhimbja më therëse, e kthyer në një torturë të përherëshme, që shoqëroi pjesën e dyzuar të personalitetit të saj, atë të jetës intime, të kujtimeve të dashurive familjare të fëminisë e të rinisë së parë, e skalitur në kujtesën e saj prej tetëmbëdhjetë vjeçareje në figurat e nënës e motrës, qe pamundësia për t'i parë edhe njëherë ato. Janë të njohura përpjekjet e ndërhyrjet e drejtuesve kryesorë të botës së atëherëshme pranë autoriteteve shqiptare për të bërë të mundur bashkimin e Nënë Terezës me familjaret e saj, të mbetura në Shqipëri. Ato i përgjigjen emrave të një Xhon F. Kenedi, të një Sharl dë Goli, të një U Thant-i, të një Indira Gandi e sa e sa të tjerë. Por Shqipëria, që kishte patur, në të shkuarën e pushtimit nazifashist, burra shteti që kishin shpëtuar qindra jetë hebrenjsh me guximin dhe bujarinë shqiptare të tyre nuk gjeti, tek drejtuesit e saj komunistë, asnjë shkëndijë bujarie e shpirtmadhësie për të bashkuar, para fundit të jetës, një familje të ndarë të popullit të saj....

Të gjitha këto fakte e konsiderata i njohin mjaft shqiptarë, sigurisht i njohin mirë drejtuesit aktualë të shtetit, të pranishëm dukshëm në ceremoninë historike të 4 shtatorit 2016 në Vatikan. Por në fjalët, intervistat apo shkrimet e tyre nuk preken aspak veprimet e turpëshme që janë kryer kundrejt figurës më madhore të lindur në truallin shqiptar, ata anashkalohen sikur heshtja të kishte fuqinë e shlyerjes. Besoj se shumëkush në atë ditë të madhe, një nga ato që të detyrojnë t'i nënshtrohesh edhe kolektivisht provimit të ndërgjegjes, do të kenë pritur nje kërkim faljeje të sinqertë, zyrtare, të pamëdyshje të Shtetit shqiptar drejtuar Zotit dhe shpirtit të bardhë të Shënjtëreshës Terezë, për plagët e hapura të martirizimit të shërbyesve të fesë së Krishtit, madje të gjithë fevet. Drejtuesit e sotëm, kryetari i shtetit apo kryetarët e tjerë të institucioneve, në sajë të moshës së tyre mund të përligjin heshtjen prej struci ndaj të këqijave të parardhësve të tyre, por një qëndrim i tillë nuk nderon ata e nuk i shërben së vërtetës historike, e cila, edhe mbas gjysëm shekulli masakrimi, ende është tepër larg pohimit të saj.

Por nëse në simpoziumet studimore apo hipokrizitë politike mund të vazhdohet ende "t'i shitet sapuni për djathë" shqipfolësvet, në ditën e shënjtërimit të një bashkatdhetareje, ngjarje aq e rrallë sa, për të hasur një të ngjajshme, duhet të kthehemi 1500 vjet mbrapa, duhet të kishte qënë një farë "rrëfimi"kombëtar. Do të vlente një veprim i tillë edhe për të treguar se, më së fundi, e kemi përnjisuar mesazhin e jetës së Shënjtores tonë, se falënderojmë Zotin për dhuratën e saj e se jemi gati, të penduar për mëkatet tona të stërmëdha, të kërkojmë hirin e saj si "Mbrojtëse e Shqipërisë".

Kjo gjë nuk ndodhi e besoj se të gjitha fjalët e bukura, të zbrazura pa kursim n'ato ditë, duhen shumëzuar me zero, mbasi e shkuara jonë kriminale vazhdon të jetojë ende e strukur në strofkat e fshehta të zemrave të politikanëve tanë.

E gjithë retorika mbi "*kombin që i dhuroi botës një shërbëtore si Nënë Tereza, si kombi që ka brënda tij njerëz të cilët i përkasin pjesës së njerëzimit që është aq shumë e lidhur me dëshirën që të ndeshet me të keqen...*" (Presidenti Bujar Nishani) është një demagogji bajate dhe e rëndomtë, në sintoni me atë të njohurën e së shkuarës, nëse nuk paditet me forcën e duhur e keqja, zotëruese e së kaluarës, e nuk gjen shprehjen e vet pendesa e thellë e sinqertë, jo hipokrizia e rradhës. Madje vetë koncepti për personazhin si "shërbëtore e botës" tregon se presidenti me gjithë vullnetin e tij, nuk arrin te shkëputet nga interpretimi laik i dukurisë. Shënjtëresha e Kalkutës nuk ishte një "shërbëtore e botës", por një shërbyese e Jezu Krishtit dhe Virgjëreshës Marie, të cilët i kishin ngarkuar asaj misionin e shërbimit ndaj të braktisurvet e të varfërvet të botës. Së treti, nuk ishte kombi që i dhuroi njerëzimit Nënë Terezën, por Shën Tereza që, me dritën e saj të bijës së Krishtit, të ngjitur në qiell me hirin e Zotit, i dha Shqipërisë mundësinë e afrimit me Perëndinë dhe brezave të ardhshëm shëmbullin më të shkëlqyer të një jete në përputhje me fjalën e Zotit dhe vlerat më të larta të moralit njerëzor.

Presidenti, si përfaqësuesi më i larë i Shtetit shqiptar, që edhe në ditën madhështore të 4 shtatorit, nuk ka ende një ambasador në Shtetin e Vatikanit, duhet të bënte një "*mea culpa*" të thellë, sepse është krejtësisht e papranueshme që, në më shumë se gjashtë muaj që ishte caktuar data e shënjtërimit të një shqiptareje, të mos ngriheshin marrëdhëniet me Vatikanin në rang ambasadash. Mos pranimi i presidentit për të emëruar dy përfaqësuesit e fundit të Shqipërisë në Vatikan, nga zgjedhjet më të mira të bëra nga Qeveria aktuale, si dy nga intelektualët më të spikatur të botës shqiptare, e ngarkon atë me një përgjegjësi tepër të madhe, para së cilës frazeologjia e intervistës dhënë Radio-Vatikanit, nuk ka asnjë vlerë. Fjalët e bukura për Shën Terezën zbehen krejtësisht kur Visar Zhitit, një të përndjekuri të ndritur të komunizmit, një poeti me përmasa botërore, i cili ka qënë i pari që ka shqipëruar e bërë të njohura lutjet dhe poezitë e Shën Terezës në kulturën shqiptare, për teka të pakuptueshme, nuk i jepet emërimi si ambasador në Shtetin e Vatikanit, për t'u paraqitur me atë titull të merituar tek Papa Françesku që, në një kohë tepër të shkurtër dekretoi Shënjtëreshën shqiptare.Këto ishin disa nga përsiatjet vetiake të asaj dite të madhe, që nxori në pah edhe njëherë, mbas evropianit të futbollit, dëshirën dhe pasionin e shqiptarëve, kudo në botë, të festojnë të bashkuar vlerat e tyre kombëtare. Le t'i lutemi Shënjtëreshës Nënë Terezë e Kalkutës, që nga amëshimi në dritën e Zotit, të bekojë e ndriçojë popullin që e lindi, duke ndërmjetësuar tek i Plotfuqishmi për faljen e mëkateve të tij.

Dom Nikë UKGJINI
Shkodër

NDIHMESA E KLERIKËVE PËR KOMISINË LETRARE

(Pjesa e fundit)

Konferencë Shkencore: "Komisia Letrare Shqipe 100 vjet me pas dhe mendimi Albanologjik" mbajtur me 8 maj 2016, nga Universiteti i Shkodrës dhe Ambasada Austriake në Tiranë, mbështetur nga Konsulli i Nderit të Austrisë, z. Gjergj Leqejza. Në këtë konferencë morën pjesë 45 studiues nga fusha të ndryshme ardhur nga trevat shqiptare.

Poeti, Dom Ndre Mjeda:

Mjeda, meshtar i përkushtuar, poet, përkthyes, studiues, filolog i shquar, i heshtur e pa bujë. Në Komisinë Letrare, ku mori pjesë në 31 mbledhje, bënte një punë fisnike e studimore shumë të vyer. Shkrimet e tij, synonin afirmimin e alfabetit të porsaformuar vendosur në Kongresin e Manastirit, si alfabet i përbashkët i tërë shqiptarëve. Kurse gjatë mbajtjes së Komisisë Letrare, më botime synonte afirmimin e një gjuhe shkrimi shqip të përbashkët duke u mbështetur në të folmen e Elbasanit.

Mjeda për shkak të kontributeve të deriatëhershme në studimet linguistike, u bë protagonist në gjirin e Komisisë Letrare Shkodrane. Ai kishte punuar me kohë për ta vendosur elbasanishtën në themel të gjuhës së përbashkët të shqipes së shkruar. Jo rastësisht u zgjodh në muajn prill 1917, anëtar kryesore i ekspeditës tre javorë, s' bashku me Gjergj Pekmezin dhe Rajko Nachtigal qe u zhvillua më 1-19 Maj 1917, në Elbasan, Polisë e Holta. Komisia Letrare duke vlerësuar lart aftësitë gjuhësore të Mjedës, në mbledhjen e 3 korrik 1917, ia kishe besuar përkthimin e raportit të Nachtigalit të mbledhur gjatë ekspeditës në Shqipërinë e Mesme. nga gjuha gjermane në shqip me titull, "Çeshtja e një gjuhe shqipe të njënjëshme",

Një vit i suksesshëm mbetej ai i 1917, kur Mjeda hartoi disa vepra të rëndësishme gjuhësore, të mbetura anonime e që morën miratimin e Komisis Letrare si: "Rregullore e Ortografisë" e "Fjalor me fjalën mb e nd" etj..

Mjeda në mes debateve e kundërshtimeve që zhvilloheshin në Komisin Letrare edhe pse i heshtur në pamjen e jashtme, ideja e tij triumfoi në përzgjedhjen e elbasanishtes si gjuhë e shkruar e përbashkët shqipe e cila arriti të mbijetoj deri në vitin 1952. Ai gjatë viti 1917, arriti të botojë në Vjenë vëllimin e parë me poezi të rinis "Juvenilia" e më vonë libra të tjera shkollor duke iu përshtatur rregullave të Komisisë Për angazhimin e plotë të Mjedës, flet edhe studiuesi, Jup Kstratit, duke u shprehur se ka pasur rolin kyçës në Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe. Përndryshe Mjeda është i njohur për qëndrimin luajal, duke mbetur në pozicione të përkora gjatë veprimtarive të Komisisë Letrare. Meqenëse e folmja e Elbasanit ishte një nëndegë e gegërishtes me pika takimi me toskërishten, Mjeda filloj punën për ripunimin e teksteve shkollore shqipe me këtë gjuhë të përbashkët.

Përndryshe, Biblioteka e Komisisë e themeluar me 16 prill 1917, furnizohej me libra nga shtypshkronja "Nikaj" e "Zoja e Paperlyeme", të shkruar në gjuhën e traditës së veriut.

Atë Vinçenc Prennushi:

Prennushi, bari shpirtërorë, poet, folklorist publicist, përkthyes më vonë Kryeipeshkëv i Durrësit mori pjesë në 4 mbledhje të Komisis Letrare. Shtypi kulturore fillon të shkruaj për Prennushin me rastin e librit të parë "Kangë Popullor Gegnishte" botuar në Sarajevë në vitin 1911. Ai, për herë të parë u

paraqit në vitin 1914, edhe si dramaturg përmes dramës "Prej robnie në liri", etj. Me hyrjen e forcave ushtarake në Shkodër më 23 janar 1916, nisi bashkëpunimin me fletoren "Posta e Shqypnisë" duke përkthyer testet nga shqipja në gjuhen gjermane. Edhe këtu boton ndonjë artikull e ndonjë tregim. Më themelimin e Komisisë Letrare, nisur nga fakti i shkrimtarit, ishte i ftuar të jetë anëtar i saj. Në "Posten e Shqypnisë", me 30 dhjetor 1916, .boton një shkrim polemik, "Një vendim i Komisis Letrare" në lidhje më moskujdesin e Komisis letrare, çfarë i përket "zantore te shpeshta" në gjuhen shqipe. Sipas regjistrit të protokolli, Prennushi ka marr pjesë në mbledhjen më dt. 23, janar 1918, ku diskutoheshin temat më rendësi: si botimi Lajmevet të Komisisë Letrare, mbi shqyrtimin e librave shkollar, përkthimin e botimin në gjuhen shqipe të raportit të Nachtigalit etj. Pastaj në mbledhjen dt.13. shkurt 1918, kur ishte zgjedh anëtar e një nen komisioni i ngritur *ad hoc,* për pranimin në Komisi Letrare e apo jo të dorëshkrimit të Thimi Mitkos të propozuar nga Gjergj Pekmezi. Gjithashtu në mbledhjen dt. 10. Prill 1918, kur flitej për mosdhënien e pëlqimit të botimit "Lajmet e Komisisë", botuar në Vjen e cila rezulton se kishte gabime të shumta gjuhësore. Dhe pjesëmarrja e tij e fundit ishte e 8 maj 1918, kur flitej për format gramatikore të gjuhës.

Prennushi pa marr parasysh pjesëmarrjes së tij të pakt, shkrimet e tij në Hyllin e Dritës, Ora e Maleve, në kryeveprën e tij "Gjeth e Lule" etj... janë botuar sipas rregullave të Komisisë Letrare.

Atë Ambroz Marlaskaj:

Marlaskaj, publicist, studiues, ka marr pjesë në 10 mbledhje të Komisis Letrare. Ai ishte i njohur me shkrimet tij të revista "Hylli i Dritës", si tribun i ideve dhe polemikave të zjarrta për problemet të aktualitetit politik e social. Në gjysmën e dytë të vitit 1921 boton shkrimet "Mbi Ortografi të Sotshme" , "Si duelën të zgjedhur deputetët katolikë të Shkodrës" , "A është qeveria e Tiranës nji "Turki e Re a Jo" etj. Ndër artikujt interesant është ai me titull "Një monument pazotësie në lamë të arsimit në Shqipni" (1923).

Marlaskaj, mori pjesë në disa mbledhje të "Komisisë Letrare" për të dhënë kontributin e vet intelektual si njohës i mire i gjuhës. Marlaskaj në mbledhjen e parë më 1 shtator 1916, si anëtari më i ri në moshë, qe zgjedh sekretar i Komisisë, duke mbajtur proces verbalin e mbledhjes. Por, për shkak të angazhime që kishte me mësimet shkollore, nuk e mori për sipër që ta vazhdonte këtë detyre. Kjo kuptohet nga mospjesëmarrja e tij në disa mbledhje në vazhdim. Marlaskaj merr pjesë në mbledhje më 31, nëntor 1916, kur kishte filluar puna në hartimin një ortografie e cila duhet të dilte nga përberë prej dy dialekteve. Pastaj emri i tij figuron në mbledhje, më 15, nëntor dhe 21 nëntor, 1916, kur Mjeda propozonte që Komisia së më parë duhej të merrej më çështjen e dialekteve e pastaj për t'u futur punës së ortografisë e cila do jetë produkt i bashkimit të dialekteve. Shënohet së mori pjesë, më 12 dhjetor, 1916, kur Komisia kishte vendosur për t'i hyrë punës për përcaktimin e dialektit të elbasanishtes dhe kur flitje për angazhimin e albanologëve të huaj rreth kësaj çështje.

Sipas Tomor Osmanit, studiuesi Marlaskaj, qe Kryetar i një grupi pune për shqyrtimin e teksteve shkollor të hartuar nga Gaspër Beltoja dhe Gasper Mikeli. Ai pastaj mori pjesë më 13 dhjetor 1916, si dhe më 7 dhjetor 1917, kur u diskutua rregullorja e re e Komisie Letrare e cila u bë më e plotësuar dhe më funksionale. Gjatë vitit 1918, Marlaskaj mori pjesë në mbledhje me 13, shkurt 1918, kur diskutohej rreth librit të Thimi Mitkos për të hyrë si literaturë e Komisisë, si dhe më 24 prill 1918, kur Komisia u mor më prirjet e përemrave vehtor dhe verbin me *i* apo *j*.

Sidoqoftë Marlaskaj mbetët një anëtar dhe kontribuues i Komisis Letrare. Polemist i flakët dhe i mençur në luftën për demokraci, kulturë e përparim, një nga penat më të mprehta të kohës që idetë i shtjellon përmes artikujve polemik, vëren studiuesi Pal Doçi.

Atë Shtjefen Gjeçovi:

Kontribut për Komisinë Letare kanë dhënë në mënyrë indirekte edhe disa klerikë të tjerë, kur Komisia Letrare e Shkodrës, kërkonte për ta shtrirë veprimtarin e vet në tërë Shqipërinë. Me këtë rast anëtarë me korrespondencë që zgjedhur arkeologu, etnografi e studiues, Atë Shtjefen Gjeçovi më letrën e dt. 8. Nëntor 1916, të nënshkruar nga Kryetari Dr. Gjergj Pekmezi. Atë Gjeçovi, nga famullia e Thethit, ku për një kohë shërbente, pasi i falënderon për emërimin si anëtarë korrespondent, ai jo vetëm qe tregon vullnetin e mirë për bashkëpunim, por tregohet i përvuajtur ndaj kësaj Komisie. Në letrën e tij shprehet, se nuk din a do ketë subjekte të përshtatshme, që kanë për t'i pëlqyer Komisisë, nga përrallat dhe këngët popullore të atyre viseve. Gjeçovi, për ndryshe për problemin e gjuhës shqipe të përbashkët, kishte dhënë mendimin gjashtë vjet më parë, në veprën "Agimi i Qytetnis" (Shkodër 1910).

Dom Pjeter Gjura, famullitar i Shkodrës dhe kryeipeshkëv i më vonshëm i Kryedioqezës së Durrësit, gjithashtu qe ftuar për të dhënë kontributin e vet në Komisinë Letrare. Ai, mori pjesë në mbledhjen e dt. 8 maj 1917, të Komisisë duke dhënë mendimin e vet studimor dhe praktik rreth trajtimit të emrave dhe mbiemrave të familjeve shqiptare. Dom Pjetri vlerësohej si person i përshtatur për ketë temë, pasi ishte i lidhur drejtpërsëdrejti me popullin e Shkodrës, si bari shpirtërorë dhe udhëheqës i zyrës administrative të kësaj famullie.

Atë Dedë Berdica, personi që interesohej për mirëvajtjen e Komisisë ishte Atë Dedë Berdica. Ai, në një shkrim të zgjerua botuar të "Posta e Shqynisë " me dt. 2 kallnuer 1917, me titull: "Literatyrë e harte. Nji vendim i Komisjonit letraar", gjerësisht flet për nevojën e stabilizimit të gjuhës shqipe. Ai, në fillim përgëzon për punën qe bënë Komisia Letrare e formuar nga intelektualet shqiptar dhe angazhimin shpirtbardhës të Austro-Hungarisë në ketë drejtim. Në ketë shkrim jep dhe mendimet e veta rreth përcaktimit nga ana e Komisisë të alfabetit të elbasanishtes, duke u shprehur se gjuha shqipe, e ka tashme alfabetin dhe dialektin e vet qe nga shkrimtaret e vjetër dhe se nuk ka nevojë që gjuha të marr një dialekt tjetër të kombinuar siç është elbasanishtja.

Përndryshe, shpjegimet e terminologjisë gjuhësore të përdorur nga Komisia, për çfarë kërkonte Atë Deda, kanë marr si bazë botimet e Shoqërisë Bashkim, si "Oroe përmii abetare shqyp", 1910, dhe veprat gjuhësore të Atë Anton Xanonit, si: "Gramatika shqyp", 1909, "Çfarë na duhet nee gramatika", 1910 etj.

Përfundim

Komisia Letrare e Shkodrës (1916-198), ishte një institucion me vlera të veçanta shkencore për kohën. Ajo pati rolin e një akademie e cila u karakterizua me diskutime, debate dhe kundërshtime ne mes anëtarëve të saj, por me qëllime të pastra atdhetare dhe për një të ardhme të begatshme të përbashkët dhe të sigurt të gjuhës dhe kombit tonë.

Komisia mendoj se vendosi më të drejt që të përdorët dialekti qendrorë i Elbasanit si një kompromise asnjanës për gjuhen letrare. Edhe pse ky vendim binte mjaft në kundërshtim me dëshirat e klerikëve katolik, për të cilën dialekti i Shkodrës sipas tyre ishte më i përshtatshmi për një gjuhë letrare.

Klerikët shpresonin se *koineja* shqiptare e veriut se shpejti do të shërbente si normë letrare për të gjithë vendin, ashtu si gjuha e Dantes, kishte shërbyer si udhërrëfyes për italishten letrare.

Sidoqoftë, puna në lëmin e gjuhës, letërsisë e zhvillimit arsimor, ndikoi në zhvillimin shqipes për deri në vitin 1946 apo deri më, 26-29 janar të vitit 1952, kur në Tiranë u mbajt sesioni shkencore i gjuhës duke i mohuar vlerat shkencore dhe historike të Komisis Letrare të Shkodrës. Madje, pas viteve të çlirimit, kleri katolik i Shkodrës qe i akuzuar si "reaksionar", si përçarës e si kundërshtar i rreptë i njësimit të gjuhës shqipe.

Bile janë vënë edhe epitete të tilla si "shkolla reaksionare jezuite", "shkolla reaksionare françeskane" dhe është akuzuar veçanërisht Gjergj Fishta si frymëzues i kësaj përçarjeje. Por edhe sot e kuptojmë se e vërteta qëndronte krejt ndryshe.

Natyrisht, një mirënjohje e madhe shkon për mbretërinë Austro-Hungarisë e cila nisur edhe nga interesat e saj gjeopolitike, bëri përpjekje titanike që të formësohej një shtet i fort e i pavarur shqiptar në Ballkan dhe duke investuar në zhvillimin dhe arsimimin e brezave të ri, do siguronte një të ardhme të sigurt të gjuhës dhe shqiptarëve si popull i cili ëndërronte që të jetë përsëri pjesë e Evropës.

Dr. Tonin ÇOBANI
Tiranë

FISHTOLOGJIA E MBAJTUR PENG PREJ MË SE NJË GJYSMË SHEKULLI "SHQYPTARI" GJERGJ FISHTA

Me rastin e 145-vjetorit të lindjes (23 tetor 1871-2016)

Shqiptarizmi është thelbi përmbajtësor i veprës së Gjergj Fishtës dhe i gjithë veprimtarisë së tij shoqërore e politike, që kulmohet në tri fjalë ose togfjalësha: "*për Gjuhën Shqype*", "*për Shqyptarët*" dhe "*për Shqypninë*". Fishta edhe kur ironizon krerët e kohës *("Le ta dijë gjithë bota mbarë / Se Gjergj Fishta s'është më shqiptar"*), edhe kur akuzon Europën që mashtrohet prej tradhtive ("Ah Europë, ti kurva e motit!..."), edhe kur i mallkon krerët tradhtarë para Krijuesit ("*Perendi a ndjeve? / Trathtarët na lanë pa atdhe, / E ti rrin e gjuan me rrfe / Lisat ndër male kot*"), nuk bën gjë tjetër veçse përforcon muret e kështjellës së shqiptarizmit të vet. Një shkrim i Nasho Jorgaqit në prag të 145-vjetorit të lindjes (23 tetor 1871-2016) me titull "A ka flirtuar Fishta me fashizmin?", ta shpërbën krejtësisht mesazhin fishtjan. Dhe unë, tek po përgatisja një kumtesë përkujtimore, u shtrëngova të kërkoj argumente të tjerë, donjërin edhe duke e përsëritur.

Më kishin kërkuar të formuloja disa mendime për fishtologjinë, pra, për tërësinë e studimeve të derisotme mbi poetin dhe shkrimtarin Gjergj Fishta. Si ndodh në raste të tilla, teksa po përballesha me dy vështirësi serioze: (1-ra) për një seleksionim sa më objektiv të studimeve të derisotme mbi Fishtën dhe veprën e tij; dhe (2-ta), për të ruajtur një receptim gjithnjë e më bashkëkohor të opusit fishtjan, artikulli i Jorgaqit më kujtoi një çështje që e ka mbajtur peng fishtologjinë prej më tepër se një gjysmë shekulli.

Pengu institucional

Përse shkrimi i Nasho Jorgaqit? Sepse ai shkrim është si të thuash institucional. Nasho Jorgaqi është më i fundmi titullar i lëndës së Historisë së Letërsisë Shqiptare të periudhës së Pavarësisë në Univesitetin publik të Tiranës që mban të përjashtuar nga ajo histori autorin e "Lahutës së Malcis". Për kaq gjë ai duket se dikur ka marrë titullin "Profesor". Tani e përdor atë titull për të pasur kredibilitet me "prova e fakte" që nuk dihet se prej cilës dorë të butë i ofrohen.

Shkrimi në fjalë mbështetet në një letër që Fishta i paska dërguar nga Shkodra një oficeri italian (Jorgaqi e cilëson "*oficer fashist*") më 10 gusht 1939. Madje ajo letër na shërbehet si "*dokument prove dhe si dëshmi e së vërtetës*" me aq ngut sa autorit nuk i ka dalë koha as për t'u distancuar sado pak prej saj. *Së pari*, sa për të thënë se ku është marrë ai lloj "*dukumenti*" dhe ku mund ta gjejnë studiuesit e interesuar. *Së dyti*, sa për t'i bërë përshkrimin fizik, duke treguar për kriteret e transliterimit (nëse vinte nga një shkrim dore), si dhe sa për të përgjegjësuar autorin e përkthimit,

nëse ishte në gjuhë të huaj (italisht), siç pohohet se ka qenë shkruar ajo letër.

Pas këtyre detyrimeve apo akribive shkencore - si i quante një profesori imi - profesori ynë, Jorgaqi, mund të bënte komentet e veta e jo të spekulonte me metafora të një konotacioni pornografik siç është folja "flirtoj" me dikë a shumëkënd, pra, me fashizmin apo oficerët e tij. Përveç metaforës "flirtoj", Jorgaqi përdor edhe fjalë a shprehje të tjera spekulative, si në rastin kur shkruan se "*gjuha e dokumentit*", gjuha e letrës , pra, që ka shkruar Fishta, bën që "*t'u pritet rruga ripolitizimeve, subjektivizmave, tendenciozitetit të çfarëdo natyre qoftë*"(sic!). Duket, kështu, se po e merr në brojtje Fishtën. Por në fishtologji, kjo do të ishte më tepër se një spekulim prej profesinistësh. Është, në të vërtetë, një tendencë e shpallur prej kohësh për të demontuar thelbin e shqiptarizmit të Poetit të vetëm Kombëtar, siç e ka cilësar Eqrem Çabej (dhe shumë të tjerë) autorin e "Lahutës së Malcis".

Me gjithë atë, në shkrimin e Nasho Jorgaqit i bëhet edhe një shërbim i dobishëm fishtologjisë kur pohohet (krejt pa dashjen e autorit) një e vërtetë e madhe (e vetmja e vërtetë në atë shkrim) se "*vargjet e Fishtës i dinte përmendësh jo vetëm rinia shkollore, por i dinin edhe malësorët analfabetë* (shqiptarët - T.Ç)*, të cilët "Lahutën e Malcis" e kishin kthyer në abetare të identitetit kombëtar.*"

Është pikërisht ky komunikim i përmasave homerike i veprës fishtjane që, si duket, xhelozon pa kuptuar disa autorë të sotëm, të cilët fryhen si gjela deti vetëm për faktin se kanë botuar një apo më shumë libra (pavarësisht se janë lexuar dhe rilexuar kryesisht prej vetë atyre) dhe kanë projekte ambicioze për botime të tjera voluminoze. Performanca e kësaj race krijuesish (dhe studiuesish) bëhet e dukshme zakonisht prej batutave spekulative tashmë të bëra bajate, si: "A ka qenë Fishta fashist?", "A ka flirtuar me fashizmin?", "A është vënë në shërbim të fashistëve apo është përdorur prej tyre?", "A ka qenë kolaboracionist?", "Patriot i gënjyer nga propaganda fashiste apo nacionalist i shitur për një grusht liretash?" etj. Dikush ka përdorur edhe dyfjalëshin "Tradhti Patriotike" pa ia vënë fare shenjën e pikëpyetjes.

Retrospektiva

Më vjen nëpër mend, në këtë rast, edhe një tjetër profesor dhe akademik i kahershëm, Arben Puto, i cili pak vite më parë gërmoi për të quajtur Gjergj Fishtën (edhe Faik Konicën) kuisling në një libër të shkruar prej tij që bënte fjalë për Luftën italo-greke ("Lufta italo - greke, diktatorë e kuislingë, Toena, 2011"). Ajo luftë ka nisur më 1940, në të njëjtin vit që Fishta është ndarë kësaj jete (në dhjetor mbushën plot 76 vjet). Përse duhet përbaltur kësisoj një personalitet i letrave shqipe si Fishta?

Edhe te Puto, si në rastin e Jorgaqit, kjo pyetje

mbetet pa përgjigje. Por Putos nuk i është vënë në dispozicion thjesht një letër që nuk dihet ku është marrë dhe pse e qysh është ruajtur. Atij i është vënë në dispozicion një vepër e tërë e Roberto Morozzo della Rocca-s, që, më parë se të botohej në gjuhën origjinale, duket se është përkthyer e botuar në shqip. E themi këtë megjithëse e dimë se në origjinal ajo vepër është botuar më 1990 ("Nazione e religione in Albania : (1920-1944)") dhe në shqip më 1994 ("Kombësia dhe feja në Shqipëri : 1920-1944"), përkthyer prej Luan Omarit.

Puto, duke cituar Morozzo della Rocca-n, e bën Gjergj Fishtën kuisling dhe e përbalt, madje, edhe si spiun të fashizmit kundër kolegëve të vet françeskanë. Për "prova dhe fakte", si duket nuk ka pasur nevojë fare asnjëri prej titullarëve, d.m.th., as autori (Puto) si historian shqiptar, as profesori italian Della Rocca. Të dy këtyre historishkruesve, pa kurrfarë reference, që sot e tutje mund t'u vinte në ndihmë vetëm dokumenti i zbuluar pas 77 vitesh, siç është për këtë rast, letra e Fishtës, e cila i ra në dorë Jorgaqit si prej qiellit. Por, pavarësisht çfarëdolloj komenti që mund t'i bëjnë të tjerët tekstit të shkruar prej Fishtës (si pretendohet) në këtë letër, unë mendoj se, gjithsesi, kemi të bëjmë thjesht me një letër falënderimi, dërguar një të huaji që ka shprehur konsideratat e veta njerëzore për popullin shqiptar në një artikull të publikuar aso kohe në shtypin italian.

Para Jorgaqit dhe Putos, pra edhe më herët, ka qenë ndër të tjerët edhe një studiues, Ragip Beqja, i cili, në veprën e vet "Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik shqiptar, Tiranë, 1969", kishte arritur aso kohe në përfundimin se Fishta ka qenë në shërbim të fashistëve apo të pushtuesve fashistë, si shprehet ai, "*shërbëtor besnik i Italisë fashiste*". Siç e kam vënë në dukje edhe në një ese timen të para disa viteve ("Miti dhe antimiti fishtjan", 1999), as Beqja nuk ka gjetur ndonjë dokument të mirëfilltë historik, sado që ka pasur në dorë çelësin e të gjitha arkivave shtetërore, të përgjithshme e sekrete. Sigurisht aso kohe prej tij nuk mund të kërkohej të përkthente artikullin e Enriko Grasi-it, që pohon se fjalët e fundit të shenjta të Gjergj Fishtës kishin qenë: "Jo për tjetër, por, sepse po lë armikun mbi truallin shqiptar, mua më vjen keq që më duhet të vdes" / Giorgio Fishta pronunzio queste ultime sacre parole: "Non per altro, ma perche lascio il nemico sul suolo albanese mi rincresce di dover morire". (Enriko Grasi: "Giorgio Fishta, spirito di fiama", në "Gjergj Fishta", botim i revistës Shendia, 1941, f.101.) Por nëse ky autor (Beqja) mund të justifikohej për metodën bardh e zi (madje vetëm zi) të analizës, sepse punonte nën një trysni ideologjike diktatoriale, Putos dhe Jorgaqit nuk u falet sot të arsyetojnë vetëm zi e më zi e të mos ndalën meritueshëm edhe në faktet që nuk përputhën me paragjykimet e tyre tashmë të dala boje.

Përmbyllja

Pas paraqitjes skematike të qëndrimeve të këtyre tre autorëve më lejoni të arsyetoj shkurtimisht diçka më tepër për atë që premton titulli i kësaj kumtese që lidhet me Fishtologjinë e mbajtur peng prej më se një gjysmë shekulli. Mbajtja peng është fakti që Fishta vazhdon të lakohet për marrëdhëniet e tij me të huajt dhe posaçërisht me fashizmin, ndërsa fishtologjia i shmanget për këtë shkak objektit të vet kryesor, studimit të veprës fishtjane dhe vendosjes së saj në vendin e merituar të historisë së letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Si dihet, autorit të "Lahutës së Malcis" i ka takuar të jetojë dy Lufta Botërore. Në të dyja ka qenë aktiv: si françeskan, si drejtor shkolle, si publicist, si veprimtar shoqëror e politikan, si dhe (veçanërisht) si shkrimtar, që *ka shkruar në të gjitha gjinitë, dhe në të gjitha me sukses* (Konica).

Gjatë Luftës së Parë ai drejtoi gazetën Posta e Shqipërisë, financuar nga Austria. Pavarësisht këtij fakti, në shkrimet e tij dhe përgjithësisht në faqet e asaj gazete emri "Shqyptar" është shkruar me shkronjë të madhe, ndoshta edhe më të madhe se "A"-ja e madhe, me të cilën shkruhej në atë gazetë fjala "*Austri*".

Gjatë Luftës së Dytë Fishta ishte anëtar i Akademisë Italiane, duke u bërë kështu ("*Shqyptari*") më i pari akademik përkrah personaliteteve më të shquar jo vetëm të Italisë, por të mbarë Europës. Fishta ka qenë ftuar nga kjo Akademi si poet, madje si poeti më i famshëm i kombit të vet, si poeti kombëtar i Shqipërisë. Jo si poet çfarëdo dhe kuisling (Puto); as si prift katolik prej Shkodre dhe i përdorur prej fashistëve (Jorgaqi); dhe jo patjetër edhe kështu edhe ashtu, por aspak poet kombëtar, si e bëjnë dhe e shkruajnë sot disa gazetarë e autorë të lodhur, të cilët me të vërtetë flirtojnë me profesionin e tyre.

Në një shkrim të kohëve të fundit diku citohet e plotë kronika e vdekjes së Fishtës, botuar në "Corriere della Sera" (31 dhjetor 1940). Në atë kronikë nuk thuhet se vdiq një fashist (apo bashkëpunëtor i fashizmit, pro fashist apo... ku di ta unë çfarë tjetër kësisoj).

Por qysh në titull shkruhet: "*Vdekja e Gjergj Fishtës - poeti kombtar shqiptar"(LA morte di Giorgio Fishta*, il poeta nacionale albanese").

Për hir të së vërtetës, këtë cilësim - Gjergj Fishta, Poeti Kombëtar - Jorgaqi duhet ta pranonte më parë se të formulonte çfarëdolloj dyshimi për Fishtën dhe veprën e tij. Kjo vlen edhe për Puton e të tjerë. Vetëm atëherë do të mund të thuhet me plot gojë se fishtologjia është në hulli të mbarë dhe po zhvillohet pa pengesa.

Më lejoni ta mbyll këtë shkrim me vlerësimin e Faik Konicës:

"*Në shekullin XX kemi disa vepra të njohura të cilat mund të merren si letërsi e njëmendtë... Pikësëpari dua të përmend Gjergj Fishtën, fratin françeskan nga Zadrima, i cili nuk është vetëm poet i zakonshëm: ai për ndonja çerek shekulli është një udhëheqës i spikatur intelektual.*"

KONFERENCË SHKENCORE NDËR BALLKANIKE NË PODGORICË

Kujdesi i shqiptarëve për Gjon Vlladimirin

Në Podgoricë, Mali i Zi, 21 tetor 2016, u mbajt Konferenca Shkencore Ndërballkanike, më temë: 1000 vjetori i Shën Gjon Vlladimirit, organizuar nga Akademia e Shkencave e Mali të Zi e Shqipërisë, me pjesëmarrjen e Akademisë se Bullgarisë dhe Maqedonisë. Në konferencë morën pjesë 22 studiues nga Ballkani, ku shpalosën në gjuhen angleze dhe serbokroate arritjet shkencore më të fundit, për Gjon Vlladimirin dhe rrethanat politike të kohës që kishin mbërthye Ballkanin. Kumtuesit nga Shqipëria, folën për, vendin që zënë Vlladimiri në liturgjinë kishtare shqiptare, restaurimi i Kishës së Shën Gjonit në Elbasan, reliktet e Vlladimirit në Muzeun Historik etj.. Nga temat e shpalosura, dolën të përbashkëtat për Gjon Vlladimirn (970-1016), dhe veprën tij, por dhe dallimet evidente shkencore që ekzistojnë në mes këtyre shteteve në trajtimin e historisë së kësaj periudhe, e sidomos çfarë i përket Mali të Zi dhe Maqedonisë.
Tema e cila shtoj huti tek malazezet ishte: Kryedioqeza e Tivarit dhe Gjon Vlladimiri, ku autori, Dom Nikë Ukgjini, duke u mbështetur në fakte historike, vuri në pah rolin që ka luajtur Kisha katolike në zmbrapsjen e ortodoksizmit serb në Diokle si dhe vendet të tjera përreth të banuara më Arbëror. Gjithashtu në ligjëratë u theksua së, Gjon Vlladimiri, ishte i pranuar dhe i nderuar prej shqiptarëve deri në maksimumin e duhur, në krahasim më malazezet e serbet të cilët e konsiderojnë si të vetin.
Studiuesit në ditën e dytë, vizituan reliktet e Vlladimirit në Muzeun Historik në Tirane dhe Kishën e kushtuar Gjon Vlladimirit në Elbasan.

VITRINË LIBRI

Atë Leonardo Di Pinto O.F.M.

IMZOT VINÇENC PRENNUSHI ME SHOKË MARTIRË I

Arqipeshkvia Shkodër/Pult
2016

Atë Leonardo Di Pinto O.F.M.

IMZOT VINÇENC PRENNUSHI ME SHOKË MARTIRË II

Arqipeshkvia Shkodër/Pult
2016

M.Dibra; I.Bala; N.Laçej

DESHMI MONUMENTALE NE VUKSANLEKAJ

MEDIAPRINT
SHKODER, 2016

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë